



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**RAPORT**

**I**

**PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

**MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT PËR VITIN 2011**

**TIRANË 2012**

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

<b>HYRJE</b> .....	<b>6</b>
<b>VOLUMI I PUNËS I ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2011</b> .....	<b>7</b>
<b>PEZULLIMET</b> .....	<b>13</b>
<b>MOSFILLIMET</b> .....	<b>16</b>
<b>PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE TË RRETHEVE GJYQËSORE</b> .....	<b>17</b>
<b>KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT</b> .....	<b>19</b>
<b>KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL</b> .....	<b>22</b>
<b>TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE</b> .....	<b>26</b>
<b>TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT PËR VITIN 2011</b> .....	<b>27</b>
<b>KREU II, SEKSIONI I, “KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE”</b> .....	<b>30</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	30
<i>TENDENCA</i> .....	32
<b>VEPRAT PENALE TË KRYERA ME DASHJE KUNDËR SHËNDETIT</b> .....	<b>38</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	39
<i>TENDENCA</i> .....	40
<b>VEPRAT PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHATËZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS</b> .....	<b>45</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	46
<i>TENDENCA</i> .....	46
<b>KRIME SEKSUALE</b> .....	<b>47</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	48
<b>VEPRAT PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT</b> .....	<b>49</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	50
<i>TENDENCA</i> .....	51
<b>VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE</b> .....	<b>53</b>

<b>“VJEDHJA E PASURISË” .....</b>	<b>53</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	54
<i>TENDENCA</i> .....	55
<b>KREU III, SEKSIONI II.....</b>	<b>64</b>
<b>“MASHTRIMET” .....</b>	<b>64</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	65
<i>TENDENCA</i> .....	65
<b>SHKATËRRIMI I PRONËS .....</b>	<b>67</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	68
<i>TENDENCA</i> .....	69
<b>KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE .....</b>	<b>77</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	78
<i>TENDENCA</i> .....	79
<b>FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË .....</b>	<b>82</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	83
<i>TENDENCA</i> .....	84
<b>VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET .....</b>	<b>93</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	94
<i>TENDENCA</i> .....	95
<b>VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT .....</b>	<b>98</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	99
<i>TENDENCA</i> .....	100
<b>VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK.....</b>	<b>104</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	105
<i>TENDENCA</i> .....	106
<b>VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TRAFIQET E PALIGJSHME .....</b>	<b>109</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	110
<i>TENDENCA</i> .....	111
<b>VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE.....</b>	<b>118</b>

<i>TE PANDEHURIT</i> .....	119
<i>TENDENCA</i> .....	119
<b>VEPRAT PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT .....</b>	<b>121</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	122
<i>TENDENCA</i> .....	123
<b>VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT .....</b>	<b>125</b>
<b>VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE.....</b>	<b>126</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	127
<i>TENDENCA</i> .....	129
<b>VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË .....</b>	<b>153</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	154
<i>TENDENCA</i> .....	155
<b>VEPRAT PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE .....</b>	<b>163</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	164
<i>TENDENCA</i> .....	165
<b>VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME ZHVILLIMIN E PALEJUAR TË LOJRAVE TË FATIT .....</b>	<b>167</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	168
<i>TENDENCA</i> .....	169
<b>VEPRAT PENALE QË CËNOJNË RREGJIMIN JURIDIK TË TOKËS .....</b>	<b>171</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	172
<i>TENDENCA</i> .....	172
<b>VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME KRIMIN KOMPJUTERIK .....</b>	<b>175</b>
<b>VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT” .....</b>	<b>176</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	177
<i>TENDENCA</i> .....	178
<b>VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME KULTIVIMIN DHE PRODHIMIN E NARKOTIKËVE” .....</b>	<b>184</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	185

<i>TENDENCA</i> .....	186
<b>VEPRAT PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETËRORË</b> .....	<b>193</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	193
<i>TENDENCA</i> .....	194
<b>VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME KRIMIN E ORGANIZUAR</b> .....	<b>197</b>
<i>TE PANDEHURIT</i> .....	198
<b>DINAMIKA E VEPRAVE PENALE TË PARASHIKUARA NGA LIGJI NR. 8003, DATË 28.09.1995 “KODI PENAL USHTARAK” (I NDRYSHUAR)</b> .....	<b>199</b>
<b>TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2011</b> .....	<b>200</b>
<b>GJINIA E TË PANDEHURVE, 2007-2011</b> .....	<b>204</b>
<b>TË PANDEHUR TË MITUR</b> .....	<b>205</b>
<b>TË DHËNA MBI LLOJET E DËNIMEVE TË KËRKUARA NGA PROKURORËT</b> ....	<b>211</b>
<b>TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA PËR VITIN 2011</b> .....	<b>219</b>
<b>ANALIZË E GRUPTREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË</b> .....	<b>221</b>
<b>II. ANALIZË E TENDENCAVE TË KRIMINALITETIT PËR VITIN 2011</b> .....	<b>227</b>
<i>II.1 TENDENCAT NË RITJE:</i> .....	227
<i>II. 2 TENDENCAT NË ULJE:</i> .....	229
<b>III. ANALIZË E DISA TREGUESVE NË RITJE TË NDJEKJES PENALE NË HETIMET PARAPRAKE DHE NË GJYKIM</b> .....	<b>231</b>
<b>IV. REFORMIMI I PROKURORISË, RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA DHE ME MISIONET NDËRKOMBËTARE</b> .....	<b>236</b>
<b>MARRËDHËNIET ME MISIONET NDËRKOMBËTARE</b> .....	<b>243</b>
<b>V. PRIORITETET E PROKURORISË PËR VITIN 2012</b> .....	<b>246</b>

## HJRJE

### **E nderuara zonja Kryetare e Kuvendit!**

### **Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë!**

Raporti vjetor mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2011 paraqitet në përmbushje të detyrimit kushtetues parashikuar në nenin 149 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 53 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar).

Në këtë raport paraqitet në mënyrë të plotë e me realizëm gjendja e kriminalitetit për vitin 2011, të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë si dhe drejtimet dhe përparësitë që kërkojnë zgjidhje dhe mbështetjen tuaj, me synim rritjen më tej të efikasitetit në luftën kundër kriminalitetit.

Nisur nga analiza e treguesve të veprimtarisë në të gjithë nivelet e prokurorisë, mund të themi se viti 2011 evidenton progres në rritje të organit të akuzës në ushtrimin e përgjegjësi kushtetuese e ligjore. Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare vërehet jo vetëm një rritje e volumit të punës, por dhe efektivitetit dhe ligjshmërisë në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen e akuzës në emër të shtetit, ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikqyrjes së vuajtjes së dënimit si dhe në ushtrimin e funksioneve të tjera të ngarkuara me ligj. Kjo tablo dëshmon për angazhimin e tërë trupës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në drejtim të rritjes së profesionalizmit dhe efektshmërisë së institucionit në përmbushjen e detyrave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji.

Pavarësisht nga të dhënat që prezantohen, jemi të vetdijshëm se duhet të merren masa të tjera të domosdoshme, për të garantuar rritjen e suksesit në luftën kundër krimit, nëpërmjet sigurimit të mbështetjes dhe bashkëpunimit me të gjitha strukturat e tjera të shtetit që funksionojnë për këtë qëllim.

Kjo detyrë është aktuale, për të përmbushur angazhimet që ka Shqipëria në kuadrin integritetit në strukturat e Bashkimit Europian, ndaj dhe roli i prokurorisë dhe i aktorëve të tjerë të sistemit të drejtësisë penale në përmbushjen e kësaj detyre është determinant.

Mënyra më sintetike e përshkrimit të punës së Prokurorisë në ushtrimin e funksioneve të saj është gjuha e shifrave, prandaj ju paraqes të grupuara treguesit e punës, shtrirjen dhe tendencat e kriminalitetit, si më poshtë:

## VOLUMI I PUNËS I ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2011


Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar. Funkzioni i prokurorit duhet të ushtrohet në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Prokuroria si organ i pavarur punën e saj e bazon në parimin e pavarësisë kundrejt të gjithë pjesëmarrësve në procesin penal si dhe organeve të tjera shtetërore.

Organet e prokurorisë janë:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda;
- c) Prokuroritë pranë gjykatave të Apelit;
- d) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
- e) Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë.

Gjatë vitit 2011, në organin e prokurorisë janë trajtuar 32770 procedime për vepra penale të ndodhura. Nga këto, janë ndjekur 24977 procedime penale (rritje prej 1,91% (për qind) në krahasim me vitin 2010; prej të cilave janë regjistruar 19728 procedime penale (rritje prej 2,29% (për qind) në krahasim me vitin 2010; janë mbartur nga viti i kaluar 4686 procedime (rritje prej 6,13% ( për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe janë rifilluar 563 procedime (ulje prej 30% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Është vendosur mosfillimi për 7793 procedime, që do të thotë rritje prej 11,07% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

### Volumi i punës në hetim per vitin 2011




Gjatë vitit 2011 nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 7424 procedime (rritje prej 1,19% në krahasim me vitin 2010) me 9256 të pandehur, përkundrajt 9261 të pandehur në vitin 2010. Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 9956 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal.

Nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 3142 çështje themeli (rritje prej 17,15% në krahasim me vitin 2010) dhe 1679 raste për masat e sigurimit personal (rritje prej 4,67% në krahasim me vitin 2010).

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për gjykime themeli, masa sigurimi personal, përfaqësime në Kolegjet e Bashkuara dhe në cilësinë e subjektit të interesuar në mbrojtje të interesave të shtetit dhe të individëve pranë Gjykatës Kushtetuese për 327 çështje.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Më poshtë paraqitet grafikisht volumi i punës i organit të prokurorisë për vitet 2010-2011:




### VOLUMI I PUNES I ORGANIT TE PROKURORISE 2010-2011



Më poshtë paraqitet grafikisht volumi i punës i organit të prokurorisë për procedimet penale të regjistruara në pesë vitet e fundit:

### CESHTJE TE REGJISTRUARA 2007-2011




Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2008 janë regjistruar 17352 procedime, që do të thotë se ka rritje të procedimeve penale prej 8,7% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në

vitin 2009 janë regjistruar 16910 procedime, që do të thotë se ka një ulje prej 2,54% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 janë regjistruar 19286 procedime, që do të thotë rritje prej 14% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2010 janë regjistruar 19726 procedime, që do të thotë rritje prej 2,28% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Rritja e volumit të punës së organit të prokurorisë vihet re edhe në procedimet penale që kanë qenë në ndjekje penale.

### NË NDJEKJE PENALE 2007-2011



Sikurse vihet re edhe nga grafiku, procedimet në ndjekje penale nga organi i prokurorisë kanë ardhur gjithnjë në rritje: kështu, në vitin 2008 kanë qenë 21278 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 20,14% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 janë 22276 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 4,69% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 janë 24506 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 10% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 janë 24977 procedime penale në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 1,92% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Në lidhje me çështjet e përfunduara, në vitin 2008 ka rritje prej 3,39% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 7% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 9,34% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 ka përsëri rritje prej 2,28% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Në lidhje me çështjet e pushuara, në vitin 2008 ka ulje prej 12,53% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 9,8% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 4,37% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 ka ulje prej 12,6% (për qind) në krahasim me vitin 2010.


Në lidhje me çështjet e pezulluara, në vitin 2008 ka rritje prej 7,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 rritje prej 27% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka

rritje prej 15,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 ka përsëri rritje prej 15,87% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Në lidhje me çështjet e dërguara në gjyq, në vitin 2008 ka rritje prej 7,68% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 5,84% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 10,78% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 ka rritje prej 119% (për qind) në krahasim me vitin 2010.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

### PROCEDIME TË PËRFUNDUARA 2007-2011



Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake.

## TË PANDEHUR TË PËRFUNDUAR




Sikurse vihet re nga tabela, rezulton se numri të pandehurve të dërguar në gjyq në vitin 2008 ka rritje prej 13,04% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje të pandehurve të dërguar në gjyq prej 4,28% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 10,88% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 janë dërguar në gjyq 9256 të pandehur, përkundrejt vitit 2010 kur janë dërguar gjyqit 9261 të pandehur.

Në lidhje me pushimin e akuzës për të pandehurit, dinamika në pesë vitet e fundit është e tillë që: në vitin 2008 ka ulje prej 20,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 3,77% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 36,73% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 ka ulje të lehtë prej 1,37% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë dhe vendimet e gjykatës në lidhje me pafajësinë në pesë vite, 2007-2011:

Në lidhje me vendimet e gjykatës për pafajësinë, rezulton nga të dhënat statistikore se: në vitin 2008 ka rritje prej 6,28% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 29,56% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka ulje prej 0,41% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 ka ulje prej 2,5% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

## TE PANDEHURIT DHE PAFAJËSIA



Nga të dhënat statistikore rezulton se: në vitin 2007 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,26% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate; në vitin 2008, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,13% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate; në vitin 2009, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,88% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate dhe në vitin 2010, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,59% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate dhe në vitin 2011, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,52% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate.


Vendi që zënë vendimet e gjykatës për pushimin e çështjeve, përkundrejt numrit total të çështjeve të dërguara në gjyq, rezulton të jetë si më poshtë:

Në vitin 2007 vendimet e gjykatës për pushimin e çështjes zënë 9,09% në numrin e përgjithshëm të çështjeve të dërguara gjyqit; në vitin 2008, kjo e dhënë rezulton të jetë 11,36% (për qind); në vitin 2009 kjo e dhënë është 2,9% (për qind); në vitin 2010 është 3,42% (për qind) dhe në vitin 2011 vendi që zënë vendimet e gjykatës për pushimin e çështjeve në numrin e përgjithshëm të çështjeve të dërguara gjyqit, është 3,11% (për qind).

## PEZULLIMET

Mbështetur në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, prokurori është organi kompetent për të vendosur pezullimin e hetimeve kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendimin e prokurorit.


Ky tregues në vitet 2007-2011, rezulton nga të dhënat statistikore si më poshtë:

**PROCEDIME TË PEZULLUARA  
2007-2011**

Në lidhje me pezullimet rezultojnë nga të dhënat statistikore se: në vitin 2008 ka rritje prej 7,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 27,02% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 15,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 ka rritje prej 15,87% (për qind) në krahasim me vitin 2010, të vendimeve të prokurorit për pezullimin e hetimeve.

Për vitin 2011, procedimet penale të pezulluara për moszbulim të autorit sipas veprave penale paraqiten grafikisht si më poshtë (për efekt të paraqitjes grafike tek ndarja 07 të tjera janë përfshirë procedime penale të pezulluara numri i të cilave është nën shifrën 19 procedime):

PROCEDIME TE PEZULLUARA SIPAS VEPRAVE PENALE 2011




## MOSFILLIMET

Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit të veprave penale të cilat mund të vijnë nga subjekte e në rrugë të ndryshme. Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim të bërë nga subjektet e parashikuara nga nenet 281 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë elementët e veprave penale. Me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme, ligjvënësi në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që në mungesë të ekzistencës së rrethanave për fillimin e procedimit, të japë vendimin e arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

Ky tregues i punës, i parë edhe si mjet për të evituar hetimet e panevojshme për kallëzimet ku mungon baza ligjore, ka pësuar një rritje këtë vit në krahasim me vitin e kaluar. Kështu, ndërsa në vitin 2010 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 7016 kallëzime, në vitin 2011 janë marrë 7793 vendime të tilla.

## PROCEDIME MOSFILLUAR 2006-2011



Në lidhje me procedimet për të cilat është vendosur mosfillimi, rezultojnë nga të dhënat statistikore se:

në vitin 2007 ka rritje prej 19,04% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 13,64% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 22,63% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 23,54% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 ka rritje prej 11,07% (për qind) në krahasim me vitin 2010.




## PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE TË RRETHEVE GJYQËSORE

Rezulton nga të dhënat statistikore se:

në prokurorinë e rrethit gjyqësor Berat në vitin 2011 janë regjistruar 889 procedime penale, që do të thotë rritje prej 44,55% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Dibër në vitin 2011 janë regjistruar 407 procedime penale, që do të thotë rritje prej 13,37% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Fier në vitin 2011 janë regjistruar 893 procedime penale, që do të thotë rritje prej 0,67% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Korçë në vitin 2011 janë regjistruar 1294 procedime penale, që do të thotë rritje prej 13,5% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Krujë në vitin 2011 janë regjistruar 424 procedime penale, që do të thotë rritje prej 23,61% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kukës në vitin 2011 janë regjistruar 341 procedime penale, që do të thotë rritje prej 12,54% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Lezhë në vitin 2011 janë regjistruar 696 procedime penale, që do të thotë rritje prej 11,53% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Mat në vitin 2011 janë regjistruar 263 procedime penale, që do të thotë rritje prej 9,58% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Pukë në vitin 2011 janë regjistruar 132 procedime penale, që do të thotë rritje prej 15,78% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Sarandë në vitin 2011 janë regjistruar 600 procedime penale, që do të thotë rritje prej 12,57% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër në vitin 2011 janë regjistruar 1429 procedime penale, që do të thotë rritje prej 13,95% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tropojë në vitin 2011 janë regjistruar 134 procedime penale, që do të thotë rritje prej 22,93% (për qind) në krahasim me vitin 2010;


Në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës në vitin 2011 janë regjistruar 1740 procedime penale, që do të thotë ulje prej 15,24% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan në vitin 2011 janë regjistruar 1502 procedime penale, që do të thotë ulje prej 10,27% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Gjirokastrë në vitin 2011 janë regjistruar 574 procedime penale, që do të thotë ulje prej 4,65% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kavajë në vitin 2011 janë regjistruar 365 procedime penale, që do të thotë ulje prej 4,94% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kurbin në vitin 2011 janë regjistruar 278 procedime penale, që do të thotë ulje prej 19,42% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Lushnjë në vitin 2011 janë regjistruar 453 procedime penale, që do të thotë ulje prej 5,23% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Pogradec në vitin 2011 janë regjistruar 453 procedime penale, që do të thotë rritje prej 36,44% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë në vitin 2011 janë regjistruar 5126 procedime penale, që do të thotë ulje prej 0,69% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Vlorë në vitin 2011 janë regjistruar 1489 procedime penale, që do të thotë ulje prej 0,4% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në Prokurorinë për Krime të Rënda janë regjistruar 108 procedime penale në vitin 2011, që do të thotë ulje prej 2,7% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Përmet në vitin 2011 janë regjistruar 94 procedime penale.

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja gjeografike sipas procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2011 në prokuroritë e rretheve gjyqësore si dhe përqindjet përkatëse:

### PROCEDIME TE REGJISTRUARA 2011



### KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000<sup>1</sup> banorë në vitin 2011 është 695.12. Në vitin 2010, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ka qenë 529.

Në lidhje me koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë, rezultojnë nga të dhënat statistikore se:

<sup>1</sup> Përlogaritja e koeficientit të kriminalitetit është bërë mbi të dhënat e dërguara nga INSTATi me shkresën nr. 37/1, datë 24.01.2011 të Institutit të Statistikave. Është numri i popullsisë vetëm sipas qarqeve për vitin 2011, rezultate paraprake të Censurit të Popullsisë dhe Banesave 1 Tetor 2011.


në prefekturën Berat që përfshin prokurorinë e rrethit gjyqësor Berat koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 432,8; në prefekturën Dibër që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Dibër dhe Mat, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 490.3; në prefekturën Durrës që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Durrës dhe Krujë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 507.2; në prefekturën Elbasan që përfshin prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 557.2; në prefekturën Fier që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Fier dhe Lushnje koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 630.6; në prefekturën Gjirokastrë që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Gjirokastrë dhe Përmet koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 718.1; në prefekturën Korçë që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Korçë dhe Pogradec koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 718.2; në prefekturën Kukës që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Kukës dhe Tropojë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 733.2; në prefekturën Lezhë që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Lezhë dhe Kurbin koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 792.5; në prefekturën Shkodër që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Shkodër dhe Pukë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 792.5; në prefekturën Tiranë që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Kavajë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 888.6 dhe në prefekturën Vlorë që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Vlorë dhe Sarandë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 1133.6;

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



## KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

### PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL



Rezulton nga të dhënat statistikore se:

1. Pesha specifike që zënë veprat penale **“Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”** për të cilat janë regjistruar 231 procedime penale në vitin 2011, është 1.17%;
2. Pesha specifike që zënë veprat penale **“Krime në fushën e doganave”** për të cilat janë regjistruar 240 procedime penale në vitin 2011, është 1.21%;
3. Pesha specifike që zënë **“Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”** për të cilat janë regjistruar 364 procedime penale në vitin 2011, është 1.84% (për qind);
4. Pesha specifike që zënë **“Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë”** për të cilat janë regjistruar 426 procedime penale në vitin 2011, është 2.15% (për qind);
5. Pesha specifike që zënë **“Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit”** për të cilat janë regjistruar 526 procedime penale në vitin 2011 është 2.66% (për qind);
6. Pesha specifike që zënë **“Krime kundër jetës të kryera me dashje”** për të cilat janë regjistruar 660 procedime penale në vitin 2011, është 3.34% (për qind);
7. Pesha specifike që zënë **“Mashttrimet”**, për të cilat janë regjistruar 702 procedime penale në vitin 2011, është 3.55% (për qind);
8. Pesha specifike që zënë veprat penale që lidhen me **“Shkatërrimi i pronës”**, për të cilat janë regjistruar 941 procedime penale në vitin 2011, është 4.77% (për qind);
9. Pesha specifike që zënë **“Falsifikimi i dokumenteve”** për të cilat janë regjistruar 998 procedime penale në vitin 2011, është 5.05% (për qind);
10. Pesha specifike që zënë **“Veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit”**, për të cilat janë regjistruar 1140 procedime penale në vitin 2011, është 5.77% (për qind);
11. Pesha specifike që zënë **“Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”**, për të cilat janë regjistruar 3630 procedime penale në vitin 2011, është 18.40% (për qind);
12. Pesha specifike që zënë veprat penale në lidhje me **“Vjedhja e pasurisë”**, për të cilat janë regjistruar 8417 procedime penale në vitin 2011, është 40.63% (për qind).

Më poshtë paraqitet grafikisht procedimet penale të regjistruara sipas strukturës së Kodit Penal në vitet 2010-2011<sup>2</sup>:

2


S1\_K2 “Krime kundër jetës të kryera me dashje; S2\_K2 “Krime kundër jetës shkakuar me pakujdesi; S3\_K2 “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit; S4\_K2 “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia; S5\_K2 “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës; S6\_K2 “Krime seksuale; S7\_K2 “Vepra penale kundër lirisë së personit; S8\_K2 “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit; S9\_K2 “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes; S10\_K2 “Vepra penale kundër lirisë së besimit; S1\_K3 “Vjedhja e pasurisë; S2\_K3 “Mashttrimet; S3\_K3 “Shkatërimi i pronës; S4\_K3 “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare; S5\_K3 “Krime në fushën e doganave; S6\_K3 “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet; S7\_K3 “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë; S8\_K3 “Falsifikimi i



dokumenteve; S9\_K3 òVepra penale në fushën e falimentimit; S10\_K3 òZhvillimi i palejuar i lojtrave të fatit; S11\_K3 òVepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës; S1\_K5 òKrime kundër pavarësisë dhe integritetit; S2\_K5 òKrime kundër rendit kushtetues; S1\_K8 òVepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit; S2\_K8 òVepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërore ose në shërbim publik; S3\_K8 òVepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike; S4\_K8 òVepra penale kundër sekretit dhe kujfije shtetërore;




Më poshtë paraqitet analizë e strukturës së kriminalitetit sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale për vitet 2010 dhe 2011 duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë nga Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak.



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2011 janë regjistruar rreth 13902 krime, përkundërt vitit 2010 kur janë regjistruar rreth 13766, që do të thotë rritje e këtij treguesi në vitin 2011 prej 0,98% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2011 janë regjistruar rreth 4043 kundërvajtje penale, përkundërt vitit 2010 kur janë regjistruar 3618 të tilla, që do të thotë rritje prej 11,74% (për qind) e këtij treguesi në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010.

Vëmë në dukje faktin se në rubrikën ÷Të përzieraö, me shifrat korresponduese, janë përfshirë procedime penale për të cilat nuk mund të bëhet ndarja në krime dhe kundërvajtje penale.

Grafiku i mëposhtëm paraqet përqindjet që zënë përkatësisht, krimet dhe kundërvajtjet penale në numrin total të procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë për vitin 2011



### TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Në vitin 2010 janë bërë në total 20898 njoftime, ndërkaq në vitin 2011 janë bërë 20714 njoftime, që do të thotë se kemi një ulje të lehtë prej 0,88% (për qind) gjatë vitit 2011 në krahasim me vitin 2010.

Bazuar në të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2010 janë filluar kryesisht nga prokuroria 314 procedime dhe në vitin 2011 janë filluar kryesisht 539 procedime, që do të thotë rritje prej 79,66% (për qind) në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010. Në këtë shifër nuk përfshihet ngritja e akuzave të reja nga prokurorët përtej fakteve kriminale të referuar në materialin kallëzues dhe të evidentuara gjatë hetimeve të kryera.

Kallëzime nga nëpunësit publikë, në vitin 2011 rezulton të jetë 707 kallëzime, që do të thotë ulje prej 37,65% (për qind) në krahasim me vitin 2010; ky tregues, për vitin 2010 rezultojnë 1134 kallëzime, që do të thotë rritje prej 25,30% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Kallëzime nga personeli mjekësor, për vitin 2011 rezultojnë 3 kallëzime; ndërkaq, për vitin 2010 rezulton 1 kallëzim, gjatë vitit 2009 dhe për vitin 2008 rezultojnë 5 kallëzime.

Kallëzime nga shtetasit, në vitin 2011, nga të dhënat statistikore rezultojnë 1801 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë ulje prej 10,35% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 rezultojnë 2009 kallëzime, që do të thotë ulje prej 14,80% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Kallëzime për vepra penale, që ndiqen mbi ankim, në vitin 2011 rezultojnë 373 ankime, që do të thotë ulje prej 18,55% (për qind) në krahasim me vitin 2010, ndërsa në vitin 2010 rezultojnë 458, që do të thotë rritje prej 118% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitit 2011 është marrë njoftim për 2916 ngjarje, që do të thotë rritje prej 18,29% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010 është marrë njoftim për 2465 ngjarje, që do të thotë se është një tregues në ulje prej 3,71 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Gjithashtu, theksojmë se, gjatë vitit 2011 janë marrë 13828 referime nga policia e shtetit, që do të thotë rritje e lehtë prej 0,4% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë viti 2010 janë marrë 13772 referime nga policia e shtetit, që do të thotë ulje prej 3,94% (për qind) në krahasim me vitin 2009; gjatë vitit 2009 janë marrë 14337 referime nga policia e shtetit, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 14529 referime nga policia e shtetit, që do të thotë se vihet re ulje e tyre gjatë vitit 2009 prej 1,32% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2011 janë marrë 84 kallëzime nga organet tatimore. Gjatë vitit 2010 janë marrë 85 kallëzime nga organet tatimore që do të thotë rritje prej 21,42% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Gjatë vitit 2009 janë marrë 70 kallëzime nga organet tatimore, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 32 kallëzime nga organet tatimore, që do të thotë se vihet re rritje e tyre gjatë vitit 2009 prej 2,18 herë në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2011 janë bërë 185 kallëzime nga policia Pyjore, që do të thotë rritje prej 18,58% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010 janë bërë 156 kallëzime nga Policia Pyjore, që do të thotë ulje prej 19,58% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Gjatë vitit 2009 janë bërë 194 kallëzime nga policia pyjore, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 188 kallëzime nga policia e shtetit, që do të thotë se vihet re rritje e tyre gjatë vitit 2009 prej 3,19% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2011 janë bërë 746 kallëzime nga CEZ, që do të thotë rritje prej 13,03% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010 janë bërë 660 kallëzime nga OSSH/CEZ, që do të thotë rritje prej rreth 5,2 herë në krahasim me vitin 2009. Gjatë vitit 2009 janë bërë 106 kallëzime nga OSSH, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 391 kallëzime nga OSSH, që do të thotë se vihet re ulje e ndjeshme e tyre gjatë vitit 2009 prej 72,89% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjithashtu, gjatë vitit 2011 janë bërë 67 kallëzime nga òpolici të tjeraò, që do të thotë rritje prej 26,41% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010, janë bërë 53 kallëzime nga òpolici të tjeraò gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 26,19% (për qind) në krahasim me vitin 2009 kur janë bërë 42 kallëzime pranë organit të prokurorisë edhe nga òpolici të tjeraò gjatë vitit 2009 dhe rreth 62 kallëzime gjatë vitit 2008.

### **TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT PËR VITIN 2011.**

Funksion i organit të prokurorisë është edhe ekzekutimi i vendimeve penale. Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre.

Gjatë vitit 2011, prokurorët kanë urdhëruar ekzekutimin e 7164 vendimeve penale të formës së prerë, që do të thotë rritje prej 5,92% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Nga këto vendime, janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi 3071 vendime penale të formës së prerë, ose një ulje e lehtë prej 1,09% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010, prokurorët kanë urdhëruar ekzekutimin e 6763 vendimeve penale të formës së prerë, që do të thotë rritje prej 4,35% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Nga këto vendime, janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi 3105 vendime penale të formës së prerë ose duke u krahasuar me vitin 2009 ka një rritje prej 7,7% (për qind) të këtij treguesi.

Vendime të cilët kanë mbetur pa u ekzekutuar (ku përfshihen edhe vendimet e mbartura të paekzekutuara), gjatë vitit 2011 janë 7798, që do të thotë rritje prej 24,5% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Në lidhje me këtë tregues rezulton se gjatë vitit 2011 kanë mbetur pa u ekzekutuar 12 vendime për masën e dënimit burgim i përjetshëm, përkundrajt 14 të tilla në vitin 2010; 1475 vendime me burgim gjatë vitit 2011, përkundrajt vitit 2010 kur rezultojnë 1486 të tillë; 6047 vendime për dënimin me gjobë përkundrajt 4729 në vitin 2010 dhe 264 dënime plotësuese në vitin 2011 përkundrajt 34 në vitin 2010.


Një tregues tjetër lidhet me vendin që zënë urdhrat për ekzekutim të lëshuar nga prokurori për dënime alternative dhe urdhrat për ekzekutim në lidhje me dënimin me burgim.

Në lidhje me këtë tregues, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2011, urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 22% (për qind) të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori (këtu përfshihen, urdhra për ekzekutimin e dënimeve me burgim të përjetshëm, me burgim, me gjobë, dënime plotësuese dhe dënime alternative). Urdhrat për ekzekutim të dënimeve me burgim zënë 36,26% (për qind) të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori.

Këta tregues, në vitin 2010 rezultojnë të jenë si më poshtë:

urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 18,4% (për qind) të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori (këtu përfshihen, urdhra për burgim të përjetshëm, urdhra për burgim, për gjobë, dënime plotësuese dhe dënime alternative). Urdhrat për ekzekutim të dënimeve me burgim zënë 32,15% (për qind) të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori.

**EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE  
2010-2011**



## VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT, KRIME KUNDËR JETËS KREU II, SEKSIONI I, “KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE”

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2011 është 3,27 % (për qind), për vitin 2010 është 3,19 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2011 në krahasim me vitin 2010.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Parë, Kreu i Dytë i Kodit Penal dhe konkretisht me Krimet kundër Jetës të Kryera me Dashje.

V.P. kundër Personit	2010					2011				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja	199	99	177	109	76	190	97	132	114	90
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Neni 78 Vrasja me paramendim	58	39	36	48	55	72	24	66	28	54
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	37	22	33	24	24	46	26	54	42	43
Neni 81 Vrasja e foshnjës	2	0	0	0	0	4	0	1	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	2	4	2	4	4	4	5	4	6	4
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme	1	3	1	3	6	1	2	1	2	3
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje	4	1	3	1	0	3	0	3	0	0
Neni 84 Kanosja	313	141	200	157	117	327	125	198	137	146
Totali	616	309	452	346	282	647	279	459	329	342

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2011 ka një rritje prej 5 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për krime kundër personit në krahasim me vitin 2010. Ndërkaq kemi ulje prej 9,7 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2010. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2010 prej 1,54 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 4,9 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 21,28 % (për qind) përkundrejt vitit 2010.

### TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2011 në total janë 609 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2010 në total kanë qenë 605 të pandehur në hetim.

Në vitin 2011, rezulton nga të dhënat statistikore se për 336 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë ndërsa në vitin 2010 për 349 të pandehur është ngritur akuza në gjykatë, që do të thotë ulje prej 3,7% (për qind) në vitin 2011 të këtij treguesi në krahasim me vitin 2010.

Nga të pandehurit, 32 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj (rritje prej 28%, për qind në krahasim me vitin 2010, dhe 1 femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 11 femra dhe 425 meshkuj (rritje prej 7,59% , për qind) në krahasim me vitin 2010.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2010 rezulton numër i njëjtë për të pandehur ofemra në vitin 2010 dhe në vitin 2011, 12 të pandehura femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 337 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 117 me arsim të mesëm dhe 16 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar. Për vitin 2011 vihet re një rritje e ndjeshme e të pandehurve òme arsim të lartë në krahasim me vitin 2010. Kështu, në vitin 2010 rezultojnë 4 të pandehur me arsim të lartë për këtë grup veprash penale ndërsa në vitin 2011 rezultojnë 11 të pandehur me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 11 të pandehur, që do të thotë një rritje e ndjeshme në krahasim me vitin 2010 kur rezultojnë të jetë regjistruar vetëm 1 i pandehur nën këtë të dhënë. Nga këta, 1 i pandehur është nëpunës i nivelit të lartë, 3 të pandehur është nëpunës i nivelit të ulët dhe 1 i pandehur është nëpunës i nivelit të mesëm, 3 të pandehur ònëpunës nivel ekzekutues dhe 3 të pandehur nëpunës i thjeshtë.

Nga sektori privat janë regjistruar 79 të pandehur (ulje prej 15% për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe të papunë 291 (rritje prej 9,8% (për qind) në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 251 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 219 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 433 të pandehur, vetëm 3 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 32 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, që do të thotë rritje prej 11% (për qind) e këtij treguesi për vitin 2011 në krahasim me vitin 2010.

Të dëmtuar-viktima në këtë grup veprash penale rezultojnë 10 meshkuj të mitur (mosha 14-18 vjec) dhe gjithsej 158 meshkuj madhorë, ndërsa 2 janë femra të mitur dhe 19 femra të rritur mbi 18 vjec.

Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 119 vdekje, 48 plagosje e rëndë dhe 49 plagosje e lehtë. Në krahasim me vitin 2010 rezulton ulje e njeshme e pasojës ÷plagosje e rëndëo prej 9,4% (për qind) në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010, rritje prej 10% (për qind) e pasojës ÷vdekjeo në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 dhe rritje përsëri e ndjeshme e pasojës ÷plagosje e lehtëo në vitin 2011, 49 raste në vitin 2011, ndërsa në vitin 2010 20 raste me këtë pasojë.


## TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re se në tendencë paraqiten veprat penale të parashikuara nga nenet 78 ÷Vrasja me paramendim, neni 79 ÷Vrasja në rrethana cilësuese dhe neni 84 ÷Kanosja.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 78 ÷Vrasja me paramendim, vihet re rritje prej 24% (për qind) e procedimeve penale të regjistruara për vitin 2011 në krahasim me vitin 2010.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale **“Kryera me dashje”** është **11,13 %** (për qind) për vitin 2011, ndërkohë që në vitin 2010 ka qenë 9,4% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2007-2011 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2008 ka rritje prej 18,46% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 7,79% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 30,12% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2011 ka rritje prej 24,13% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 ÷Vrasja me paramendim i Kodit Penal.



Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike për këtë vepër penale për vitin 2011:

Neni 78 "Vrasja me paramendim"




Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale, rezultojnë nga të dhënat statistikore se në prokuroritë rrethëve gjyqësore Kukës, Mat, Pogradec dhe Pukë është regjistruar nga 1 procedim penal gjatë vitit 2011; në prokuroritë e rrethëve gjyqësore Dibër, Elbasan, Kurbin dhe Sarandë kanë regjistruar nga 2 procedime penale për këtë vepër penale; në Korçë janë regjistruar 3 procedime penale; në Berat janë regjistruar 6 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 7 procedime penale; në rrethet Fier dhe Vlorë janë regjistruar nga 8 procedime penale; në Durrës dhe Lezhë janë regjistruar nga 9 procedime penale për këtë vepër penale dhe në Tiranë janë regjistruar 10 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal ÷ Vrasja me paramendim në vitin 2011.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal ÷ Vrasja në rrethet e tjera cilësuese, në vitin 2011, prej 24,32% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "**Krime kundër jetës të kryera me dashje**" është **0,23 %** (për qind) për vitin 2011, ndërkohë që në vitin 2010 ka qenë 0,19% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2007-2011 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

## Neni 79 "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese"




Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2008 ka rritje prej 14,81% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 19,35% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 48% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2011 ka rritje prej 24,32% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 ÷Vrasja në rrethana të tjera cilësuese ÷ i Kodit Penal.

Rezulton se në prokuroritë e rretheve gjyqësore Korçë, Krujë, Vlorë dhe në prokurorinë për Krime të Rënda është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale gjatë vitit 2011; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Berat, Dibër, Fier dhe Lezhë janë regjistruar nga 2 procedime penale për vitin 2011; në Shkodër janë regjistruar 5 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 6 procedime penale dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë regjistruar 11 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal ÷Vrasja në rrethana të tjera cilësuese ÷ për vitin 2011.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në prokuroritë e rretheve gjyqësore për vitin 2011 për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal ÷Vrasja në rrethana të tjera cilësuese ÷:

Neni 79 "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese




Me tendencë në rritje në këtë grup veprash penale paraqitet edhe vepra penale e parashikuar nga neni 84 të Kanosjaës.

Kështu, vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal të Kanosjaës, në vitin 2011, prej 4,47 % (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “**Krime kundër jetës të kryera me dashje**” është 1,65 % (për qind) për vitin 2011, ndërkohë që në vitin 2010 ka qenë 1,62% (për qind).

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2007-2011 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):


## Neni 84 "Kanosja"



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2008 ka ulje prej 13,30% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 15,34% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 5,43% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2011 ka rritje prej 4,47% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 84 të Kodit Penal.

Në lidhje me të pandehurit, për të cilët është vendosur rifillimi hetimeve rezulton se: Në vitin 2007 janë rifilluar hetimet për 237 të pandehur, që do të thotë 62,32% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 janë rifilluar hetimet për 136 të pandehur, që do të thotë 42,6% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 janë rifilluar hetimet për 152 të pandehur, që do të thotë rritje prej 11,76% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë rifilluar hetimet për 156 të pandehur, që do të thotë rritje prej 2,63% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2010 janë rifilluar hetimet për 150 të pandehur që do të thotë një ulje e lehtë prej 3,84% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Në vitin 2007 është ngritur akuza në gjykatë për 7719 të pandehur ose 2,52% më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 është ngritur akuzë në gjykatë për 8726 të pandehur ose 13% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 është ngritur akuzë në gjykatë për 8352 të pandehur ose 4,28% (për qind) më pak se në vitin 2008 dhe në vitin 2010 është ngritur akuza në gjykatë 9261 të pandehur që do të thotë rritje prej 10,88% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2010 është ngritur akuza në gjykatë për 9256 të pandehur që do të thotë një ulje e papërfillshme në krahasim me vitin 2010 prej 0,05% (për qind).

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e të pandehurve për të cilët kanë përfunduar hetimet dhe mënyra e përfundimit të tyre për vitet 2010 dhe 2011:



Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike të dhëna mbi të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, të pandehur të dënuar dhe të dënuar, në pesë vitet e fundit (2007-2011):



Në lidhje me të pandehurit të gjykuar në raport me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rezulton nga të dhënat statistikore se:

Në vitin 2006, 09% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar; në vitin 2007, 87,53% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar; në vitin 2008, 86% e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar; në vitin 2009, 89,2% e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar dhe në vitin 2010, 87,12% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar dhe në vitin 2010, nga të dhënat statistikore, rezulton se 92,21% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar.

Në lidhje me të pandehurit e dënuar të dhënat rezultojnë si vijon:

Në vitin 2007 janë dënuar 5859 të pandehur ose 75,9% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit; në vitin 2008 janë dënuar 7278 të pandehur ose 83,4% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit dhe në vitin 2009 janë dënuar 7172 të pandehur ose 85,87% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit dhe në vitin 2010 janë dënuar 7763 të pandehur ose 83,82% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit dhe në vitin 2011 janë dënuar 8654 të pandehur ose 93,49% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit.

Rezulton se treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve ka ardhur në rritje, kështu:

Për vitin 2005 rreth 94,86% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2006 rreth 96,94% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2007 rreth 86,71% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2008 rreth 96,76% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata dhe në vitin 2009 rreth 96,29% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata dhe për vitin 2010 rreth 96,20% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata dhe në vitin 2011 për rreth 96,21% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata.


Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në ngritjen e akuzës në fazën e hetimit paraprak rezulton se:

Në vitin 2006 rreth 74,56 % (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim; në vitin 2007 rreth 69,16 % (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim; në vitin 2008 rreth 73,24 % (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim dhe në vitin 2009 rreth 74,27 % (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim; në vitin 2010 rreth 68,38% (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim dhe në vitin 2011 rreth 67,03% (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim.


Rezulton nga të dhënat statistikore se treguesi i efektivitetit të ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak ka qenë si më poshtë:

Në vitin 2007 janë përfunduar hetimet për 9587 të pandehur nga të cilët 7719 janë dërguar për gjykim dhe për 1868 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 80,51% (për qind) e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2008 janë përfunduar hetimet për 10208 të pandehur nga të cilat 8726 janë dërguar për gjykim dhe për 1482 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 85,48% (për qind) e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2009 janë përfunduar hetimet për 9890 të pandehur nga të cilat 8352 janë dërguar për gjykim dhe për 1538 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 84,44% (për qind) e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2010 janë përfunduar hetimet për 11364 të pandehur nga të cilat 9261 janë dërguar për gjykim dhe për 2103 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 81,49% (për qind) e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2011 janë përfunduar hetimet për 11330 të pandehur nga të cilat 9256 janë dërguar për gjykim dhe për 2074 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 81,69% (për qind) e personave për të cilat është ngritur akuzë;

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet efektiviteti i ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak për vitin 2011:



**GJINIA E TË PANDEHURVE, 2007-2011**



Rezulton nga të dhënat statistikore për të pandehurit meshkuj se:

Në vitin 2007 janë 8489 të pandehur ose rritje prej 9,94% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 janë 8870 të pandehur ose rritje prej 4,48% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 janë 7555 të pandehur ose ulje prej 14,82% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 janë 9425 të pandehur ose rritje prej 24,75% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2010 janë 10474 të pandehur ose rritje prej 11,12% për qind) në krahasim me vitin 2010.


Për të pandehurit femra rezulton nga të dhënat statistikore se:

Në vitin 2007 janë 523 të pandehura ose rritje prej 14,94% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 janë 457 të pandehura ose ulje prej 12,6% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 janë 378 të pandehura ose ulje prej 17,28% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 janë 458 të pandehura ose rritje prej 21,16% në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 janë 445 të pandehura ose ulje e lehtë prej 2,83% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Në lidhje me të pandehurat femrat në raport me numrin e të pandehurve të përfunduar treguesit janë si më poshtë:

Për vitin 2007, raporti i të pandehurve femra me totalin e të pandehurve të përfunduar ka qenë 6,77% (për qind); në vitin 2008 ky tregues ka qenë 5,23% (për qind); në vitin 2009 ky tregues ka qenë 4,52% (për qind); në vitin 2010 ka qenë 4,94% (për qind) dhe në vitin 2011 është 4,80% (për qind). Pra, vihet re një tendencë konstante në lidhje me këtë tregues në pesëvjeçarin e fundit.

## TË PANDEHUR TË MITUR



Në lidhje me të pandehurit të mitur, nga të dhënat statistikore rezulton se:


në vitin 2007 rezultojnë 580 të mitur të pandehur ose 34,57% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 889 të mitur të pandehur ose 53,27% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 665 të mitur të pandehur ose 25,19% (për qind) më pak se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 870 të mitur ta pandehur ose rritje prej 30,82% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 rezultojnë 1015 të pandehur të mitur, që do të thotë rritje prej 16,66% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Në lidhje me të pandehurit të mitur, rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 nga 665 të pandehur, 636 janë meshkuj dhe 29 janë femra. Në vitin 2010, nga 870 të pandehur të mitur, 853 janë meshkuj, që do të thotë rritje prej 34,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe 17 janë femra, që do të thotë ulje prej 41,37% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Në vitin 2011, nga 1015 të pandehur të mitur, 997 janë meshkuj, që do të thotë rritje prej 16,88% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe 18 prej tyre janë femra.

Rezultojnë nga të dhënat statistikore se të miturit në raport me të totalin e të pandehurve përbëjnë: në vitin 2007 ka qenë 7,51%; në vitin 2008 ka qenë 10,18% (për qind); në vitin 2009 ka qenë 7,96% (për qind); në vitin 2010 ka qenë 9,39% (për qind) dhe në vitin 2011 është 10,96% (për qind). Pra, del në pah tendenca në rritje e këtij treguesi.

Nga të dhënat e vitit 2009 rezultojnë se janë marrë si të pandehur edhe 119 shtetas të huaj; në vitin 2010 janë marrë të pandehur 136 shtetas të huaj, që do të thotë rritje prej 14,28% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 janë marrë të pandehur 139 shtetas të huaj që do të thotë rritje prej 2,2% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen arsimore të të pandehurve:



Me arsim deri 9-vjecar:

në vitin 2007 rezultojnë 5338 të pandehur ose 4% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 5942 të pandehur ose 11,31% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 5123 të pandehur ose 13% (për qind) më pak se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 6069 të pandehur që do të thotë rritje prej 18,46% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 rezultojnë 6960 të pandehur ose rritje prej 14,68% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Me arsim të mesëm:

në vitin 2007, rezultojnë 3140 të pandehur ose 18,8% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 2965 të pandehur ose 5,57% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 2416 të pandehur ose 18,5% (për qind) më shumë se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 3279 të pandehur që do të thotë rritje prej 35,72% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 rezultojnë 3302 të pandehur, që do të thotë një rritje e lehtë prej 0,7% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Me arsim të lartë:

në vitin 2007, rezultojnë 489 të pandehur ose 35,83% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 431 të pandehur ose 11,8% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 397 të pandehur ose 7,88% (për qind) më pak se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 486 të pandehur, që do të thotë rritje prej 22,41% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 rezultojnë 536 të pandehur, që do të thotë rritje prej 10,28% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve për vitin 2011:




Përsa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, për të pandehur të cilët janë të punësuar në sektorin shtetëror, rezulton se në vitin 2010 janë 602, përkundrejt 506 të tillë në vitin 2009, që do të thotë se ka një rritje prej 18,97% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Në vitin 2011 janë 338 të pandehur nga sektori shtetëror, që do të thotë një ulje e ndjeshme në krahasim me vitin 2010 kur rezultojnë 602 të pandehur nën këtë tregues.

Rezulton nga të dhënat statistikore se të pandehur të cilët janë të punësuar në sektorin privat në vitin 2010 të jenë 1833 përkundrejt 1500 të tillë në vitin 2009, që do të thotë se ka rritje prej 22,2% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Në vitin 2011 rezultojnë 2259 të pandehur të punësuar në sektorin privat, përkundrejt vitit 2010 kur rezultojnë 1833 të pandehur nën këtë tregues.

Në vitin 2011 rezultojnë 5239 të pandehur të papunë, përkundrejt vitit 2010 kur rezultojnë 5082 të tillë, që do të thotë rritje prej 3,08% (për qind) në krahasim me vitin 2010; rezultojnë nga të dhënat statistikore se janë gjithsej 5082 të pandehur në vitin 2010, përkundrejt 4888 në vitin 2009, që do të thotë rritje prej 3,96% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendbanimin e të pandehurve:





Sikurse rezulton edhe nga tabela e mësipërme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton:

Të pandehur me vendbanim në qytet rezultojnë në vitin 2011 të jenë 6667, që do të thotë rritje prej 8,12% (për qind) në krahasim me vitin 2010; rezultojnë në vitin 2009 gjithsej 4634 të pandehur dhe në vitin 2010 rezultojnë 6166 të pandehur, që do të thotë rritje prej 33,05% (për qind) në krahasim me vitin 2009;

Në lidhje me të pandehurit me vendbanim në komunë, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2011 janë 4169 të pandehur, që do të thotë rritje 14,69% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2009 gjithsej 3247 të pandehur dhe në vitin 2010 rezultojnë 3635 të pandehur, që do të thotë rritje prej 11,94% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Pavarësisht tendecave në rritje për të dy kategoritë, kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në zonat urbane sesa në zonat rurale.

Grafiku i vijues paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve për vitin 2011:


Përsa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2011 rezultojnë 296 të pandehur të cilët janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, që do të thotë rritje prej 20,81% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2009 rezultojnë të pandehur të cilët janë përsëritës për të njëjtën vepër penale 174 persona dhe në vitin 2010 rezultojnë 245 të tillë që do të thotë rritje prej 40,80% (për qind) në krahasim me vitin 2009;

Përsëritës për vepra penale të ndryshme, rezultojnë të jenë 409 persona në vitin 2011, që do të thotë rritje prej 7,63% (për qind) në krahasim me vitin 2010; rezultojnë 304 persona në vitin 2009 dhe 380 të tillë në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Të pandehur të padënuar më parë, rezultojnë në vitin 2011 të jenë 10029 të pandehur, që do të thotë rritje prej 9,23% (për qind) në krahasim me vitin 2010; rezultojnë 7407 persona në vitin 2009 dhe 9181 të tillë në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 23,95% (për qind) në krahasim me vitin 2009.



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me pasojat në dëm të shëndetit:



Në lidhje me pasojat e veprave penale, në dëm të shëndetit, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në lidhje me pasojën ÷vdekjeë ka një rritje të lehtë prej 1,73% (për qind) në krahasim me vitin 2010; ka një rënie të pasojës me vdekje nga veprat penale gjatë vitit 2010 prej 36,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009 (540 raste në vitin 2009 dhe 345 në vitin 2010);


Pasoja nga veprat penale ÷plagosje e rëndëë rezulton në vitin 2011 me një rritje prej 4,13% (për qind) në krahasim me vitin 2010; me ulje, rezulton pasoja nga veprat penale ÷plagosje e rëndëë dhe ulja është prej 12,31% (për qind) në krahasim me vitin 2009 (276 raste në vitin 2009 dhe 242 në vitin 2010).

Me rritje rezulton në vitin 2011 edhe pasoja ÷plagosje e lehtëë prej 32,48% (për qind) në krahasim me vitin 2010; me ulje rezulton të jetë dhe pasojë e veprës penale ÷plagosje e lehtëë rezulton me ulje prej 8,32% (për qind) në krahasim me vitin 2009 (685 raste në vitin 2009 dhe 628 në vitin 2010).

Në shifrat e mësipërme përfshihen pasojat në dëm të jetës dhe të shëndetit të personave, për cdo fakt të dyshuar kriminal të hetuar, pavarësisht nga mënyra e përfundimit të procedimit rreth tij.

## TË DHËNA MBI LLOJET E DËNIMEVE TË KËRKUARA NGA PROKURORËT

Në lidhje me dënimin me gjobë, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për vitet 2007-2011



Të dhënat statistikore tregojnë për rritje të dënimeve me gjobë (kërkesa të prokurorëve) gjatë vitit 2011 prej 13,8% (për qind) në krahasim me vitin 2010; gjatë vitit 2010 dhe rritja është prej 13,09 % (për qind) në krahasim me vitin 2009. Vihet re se në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 23% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 53,92% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 3,35% (për qind) dhe në vitin 2010 ka rritje prej 13,9% (për qind) kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin 2011 ka një rritje të vendimeve të gjykatës për dënimin me gjobë prej 13,17% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje prej 11,32% (për qind) të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi; në vitin 2009 ka një ulje prej 2,44% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2008, ka një rritje të ndjeshme prej 51,88% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të vendimeve të gjykatës për dënimin me gjobë

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e dënimit me burgim nën minimumin e parashikuar nga ligji:



#### **Në lidhje me masën e dënimit me burgim në minimum:**

Vihet re se në vitin 2011 ka një ulje të kërkimeve të prokurorëve për dënimin me burgim në krahasim me vitin 2010 prej 2,87% (për qind); në vitin 2010 vihet re përsëri ulje e kërkimit të prokurorëve për këtë lloj dënimi prej 30,67% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 4,32% (për qind), kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 31,81% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të këtij treguesi dhe në vitin 2007 ka ulje të kërkimeve të prokurorëve për dënimin me burgim krahasuar me vitin 2006 prej 13,54% (për qind) në krahasim me vitin 2006.

Vihet re se në vitin 2011 ka ulje prej 6,52% (për qind) të dënimeve të gjykatës për dënimin me burgim në minimum krahasuar me vitin 2010; në vitin 2010 ka një ulje prej 22,03% (për qind) të vendimit të gjykatës për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një

rritje të lehtë prej 2,1% (për qind), të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 29,65% (për qind) në krahasim me vitin 2007.

#### Në lidhje me dënimin me burgim mesatar:

Vihet re se në vitin 2011 ka një rritje prej 16,51% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të kërkimeve të prokurorëve për dënimin me burgim mesatar; në vitin 2010 ka një rritje të theksuar prej 14,45% (për qind) të kërkimeve të prokurorit për dënim mesatar; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 2,75% (për qind), kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi; në vitin 2008 ka një rritje prej 1,1% (për qind) në krahasim me vitin 2007.

Vihet re se në vitin 2011 ka rritje të vendimeve të gjykatës prej 15,81% (për qind) në krahasim me vitin 2010 për dënim me burgim mesatar; në vitin 2010 ka rritje prej 21,08% (për qind) të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi; në vitin 2009 ka një ulje prej 4,79% (për qind), vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi; në vitin 2008 ka një ulje të lehtë prej 0,93% (për qind) në krahasim me vitin 2007.

Në pesë vite, kërkimet e prokurorëve dhe vendimet e gjykatës për masë dënimi mesatar, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e dënimit me burgim në maksimum në vitet 2007-2011:



Vihet re se në vitin 2011 ka një rritje të kërkimit të prokurorit për dënimin me burgim në maksimum prej 39,58% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje të ndjeshme prej 56,27% (për qind) të kërkimeve të prokurorit për këtë lloj dënimi, në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 4,87% (për qind), kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi; në vitin 2008 ka një ulje prej 24,35% (për qind) në krahasim me vitin 2007.

Vihet re se në vitin 2011 ka një rritje të ndjeshme të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum prej 103,44% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka ulje prej 5,84% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 4,76% (për qind), vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi; në vitin 2008 ka një ulje prej 30,33% (për qind) në krahasim me vitin 2007.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me zbatimin e nenin 59 të Kodit Penal ku është parashikuar shprehimisht ÷Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë si kërkime të prokurorit ashtu edhe vendime të gjykatës, në pesë vitet e fundit:



Nga të dhënat statistikore, vihet re se: në vitin 2011 jemi në të njëjtat nivele sikurse në vitin 2010; kështu në vitin 2010 rezultojnë 1075 raste të kërkimit të prokurorit për pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë ndërsa në vitin 2010 rezultojnë të jenë 10754 raste; në vitin 2010 ka rritje prej 17,63% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të këtij treguesi; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 0,97% (për qind), kërkime të prokurorit për pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë në parashikim të nenit 59 të Kodit Penal; në vitin 2008 ka një rritje prej 0,65% (për qind) në krahasim me vitin 2007.


Nga të dhënat statistikore, vihet re se: në vitin 2011 ka një rritje të vendimeve të gjykatës për pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë në parashikim të nenit 59 të Kodit Penal prej 3,34% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje prej 13,71% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka rritje prej 1,02% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2008 ka rritje prej 18% (për qind) në krahasim me vitin 2007 gjykatës për pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal.

Në lidhje me burgimin e përjetshëm, nga të dhënat statistikore rezultojnë se:


Në vitin 2011 ka një rritje prej 63,63% (për qind) të kerkimeve të prokurorëve për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka ulje prej 26,66% (për qind) në krahasim me vitin 2009 për këtë masë dënimi; në vitin 2009 ka një ulje prej 31,81% (për qind), kërkime të prokurorit për masën e dënimit, burgim i përjetshëm; në vitin 2008 ka një rritje prej 214,28% (për qind) në krahasim me vitin 2007 për këtë masë dënimi.

Nga të dhënat statistikore rezultojnë se: në vitin 2011 ka rritje të ndjeshme prej 116,66% në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të vendimeve të gjykatës për këtë masë dënimi; në vitin 2009 ka një ulje prej 61,53% (për qind), kërkime të prokurorit për masën e dënimit, burgim i përjetshëm dhe në vitin 2008 ka një rritje prej 160% (për qind) në krahasim me vitin 2007 për këtë masë dënimi.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:









Më poshtë paraqiten grafikisht të dhëna mbi kërkimet e prokurorëve dhe vendimet e gjykatës për vitin 2011:





## TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA PËR VITIN 2011.

Pjesë shumë e rëndësishme e punës së organit të prokurorisë janë edhe marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja. Në vijim paraqesim të dhëna statistikore në lidhje me ekstradimet nga jashtë brenda.

Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2011 janë ekstraduar fizikisht në Shqipëri 60 persona. Këto ekstradime janë realizuar si më poshtë vijon: 18 persona të ekstraduar nga Italia, 16 nga Greqia, 5 nga Mbretëria e Bashkuar, 4 nga Belgjika, 4 nga Gjermania, 3 nga Kosova, 2 Spanja, 2 nga Zvicra dhe nga 1 Franca, Holanda, Austri, Suedi dhe Bullgaria. Sikurse vihet re edhe nga të dhënat statistikore rezulton se numri më i madh i personave të ekstraduar gjatë vitit 2011 rezulton të jetë me shtetet fqinje si Italia dhe Greqia ku edhe numri i shtetasve shqiptarë që banojnë në këto vendë është më i lartë. Tendencë kjo e njëjtë me atë të viteve të mëparshme. Vihet re një rritje e lehtë krahasuar me vitin e kaluar ku numri i të ekstraduarve ishte 52 persona.

Për cdo rast për të cilin Prokuroria e Përgjithshme është njoftuar nga ZQK INTERPOL TIRANA për lokalizim apo arrestim të personave për qëllim ekstradimi, është paraqitur brenda afatit ligjor, kërkesë për ekstradim nga prokuroria në Ministrinë e Drejtësisë.

Në lidhje me kërkesat për ekstradime, nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2011 janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë në total 117 kërkesa për ekstradim dhe konkretisht: në Itali 46 kërkesa, në Greqi 39 kërkesa, në Belgjikë 6 kërkesa, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 5 kërkesa në Mbretërinë e Bashkuar 5 kërkesa, etj. Kjo shifër është dukshëm më e lartë krahasuar me vitin 2010 ku numri i kërkesave ishte 69. Janë ekzekutuar 107 kërkesa për ekstradim gjë që tregon rritjen e kredibiliteti ndaj sistemit tonë të drejtësisë dhe forcimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.

Në lidhje me kërkesat për ekstradim të autoriteteve të huaja drejtuar Shqipërisë, rezulton nga të dhënat statistikore se gjatë vitit 2011 në total janë kryer në Shqipëri 62 arrestime me qëllim ekstradimi drejt këtyre vendeve. Nga të cilët 25 persona janë shtetas shqiptarë e konkretisht 24 janë arrestuar me qëllim ekstradimi drejt Italisë dhe 1 drejt Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Theksojmë se nga data 1 Gusht 2011, ka hyrë në fuqi marrëveshja dypalëshe me Republikën e Italisë mbi bazë të së cilës lejohet tashmë ekstradimi i shtetasve shqiptarë drejt këtij vendi. Pjesa tjetër detajohet si vijon, 6 kërkesa nga Republika e Kosovës, 4 kërkesa nga Belgjika, 3 kërkesa nga Gjermania, 3 nga Mali i Zi, 3 nga Italia, 3 nga Maqedonia, 2 nga Austria, 2 nga Zvicra, 2 nga Hungaria si dhe respektivisht nga 1 nga Franca, Spanja, Çekia, Rumania, Kroacia, Serbia, Bosnje- Hercegovina dhe Emiratet e Bashkuara. Vihet re një rritje krahasuar me atë të vitit 2010 ku numri i arrestimeve ka qenë 43.

Përsa i takon ekstradimeve nga Shqipëria jashtë, gjatë vitit 2011 janë realizuar 35 ekstradime dhe konkretisht:

6 të ekstraduar për në Republikën e Kosovës;

5 të ekstraduar në Gjermani.

3 të ekstraduar në Itali (jo shtetas shqiptarë)

3 të ekstraduar në Maqedoni

3 të ekstraduar në Hungari

2 të ekstraduar në Zvicër

2 të ekstraduar në Austri

2 të ekstraduar në Bosnje Hercegovinë

Nga 1 shtetas i huaj ekstraduar respektivisht në Greqi, Poloni, Belgjikë, Çeki, Slloveni, Kroaci, Mal i Zi, Serbi dhe 1 shtetas shqiptarë ekstraduar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Vihet re një rritje krahasuar me atë të vitit 2010 ku numri i ekstradimeve për jashtë Shqipërisë ka qenë 26.

Në lidhje me transferimin e personave të dënuar nga gjykatat shqiptare janë transferuar gjatë vitit 2011, 2 persona, konkretisht për në Gjermani.

Gjatë vitit 2011 është transferuar nga jashtë shtetit në Shqipëri për të vuajtur dënimin në burgjet shqiptare 1 person i dënuar nga Maqedonia.

Lidhur me fluksin e letërporosive, kemi patur 1108 letërporosi nga jashtë shtetit dhe për jashtë shtetit, numër përafërsisht i njëjtë me atë të vitit të kaluar

Në vitin 2011 është kërkuar njohja e vendimeve penale të huaja për 46 shtetas shqiptarë nga të cilët 7 nga autoritetet italiane dhe të shoqëruara me kërkesën për arrestim provizor. Pjesa tjetër e kërkesave për njohje janë përgjithësisht nga vendet fqinje si Kosova dhe Maqedonia dhe kanë të bëjnë kryesisht me dënime me gjoba të ulta për kalim të paligjshëm të kufirit.

Kërkesat për njohje të vendimeve të autoriteteve italiane i takojnë gjysmës së parë të vitit. Kjo për arsye të një fenomeni tepër shqetësues të bërë publik edhe më parë, atë të uljes drastike të masave të dënimit të dhëna nga gjykatat shqiptare gjatë procesit të njohjes së këtyre vendimeve, dhe së dyti për shkak të hyrjes në fuqi në Gusht të marrëveshjes dypalëshe me Republikën e Italisë në bazë të së cilës tashmë mundësohet ekstradimi i shtetasve shqiptarë drejt Italisë.

Në vitin 2011 janë zhvilluar 42 komisione rogatore dhe takime info-operative me partnerët ndërkombëtarë. Vlen të përmendim këtu vecanërisht bashkëpunimin me autoritetet italiane, britanike, belge, franceze, holandeze e malazeze apo me institucione si EUROJUST.

Trafiku i mjeteve motorike vazhdon të ngelet problem shqetësues për agjencitë e specializuara të zbatimit të ligjit në Shqipëri dhe autoritetet e huaja, vecanërisht në zbulimin dhe goditjen e autorëve të këtij fenomeni transnacional.

Vazhdon të ngelet problematike çështja e Urdhërave të Arrestit Ndërkombëtar e lidhur kjo ngushtë me pamundësinë e ekstradimit të shtetasve shqiptarë (me perjashtim të rasteve kur ekziston një marrëveshje ndërkombëtare e cila parashikon ndryshe) për shkak të ndalesës kushtetuese. Problem ky i zgjidhur sa i përket urdhër arresteve të lëshuara nga autoritetet italiane të drejtësisë me hyrjen në fuqi të marrëveshjes dypalëshe.

Përfitojmë nga rasti për të evidentuar nevojën që të tilla marrëveshje të firmosen edhe me vende të tjera gjë e cila do të përmirësonte dukshëm efikasitetin e punës së agjencive ligjzbatuese në vendet firmëtare.

## ANALIZË E GRUPTREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË

Arritjet në përmbushjen e angazhimeve për prioritetet në luftën kundër kriminalitetit.

Në luftën kundër kriminalitetit, prioritet tona gjatë vitit 2011 kanë qenë: strategjitë kombëtare të miratuara, progresi i raportit dhe rekomandimet që vijnë nga partnerët e huaj për shkak të angazhimeve të shtetit shqiptar në organizmat ndërkombëtare, si dhe problematikat e punës së organit të prokurorisë dhe tendencat e kriminalitetit të evidentuara gjatë vitit 2010; - korrupsioni; - krimi i organizuar; - terrorizmi; - trafikët e paligjshme; - pastrimit të parave; - veprave penale të vjedhjes së pasurisë; - veprave penale që lidhen me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor.

### KRIMI I ORGANIZUAR DHE TRAFIQET E PALIGJSHME

Lufta kundër krimit të organizuar ka qenë dhe mbetet prioritet i punës së organit të akuzës edhe për vitin 2011. Për shkak të parashikimeve ligjore kompetencën në shkallë vendi për të ndjekur penalisht aktivitetin kriminal në kuadër të krimit të organizuar e ka në mënyrë të posacme Prokuroria për Krime të Rënda. Në analizë të treguesve të punës së kësaj zyre na rezulton një tablo si më poshtë, në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar.

Gjatë vitit 2011 në Prokurorinë për Krime të Rënda janë hetuar 204 procedime penale, prej të cilave 109 të regjistruara rishtazi. Kanë marrë zgjidhje 131 procedime, prej të cilëve janë dërguar për gjykim 48 çështje ose 47% e numrit të procedimeve të zgjidhura.

Ndër grupveprat penale të hetuara, ashtu si vitet e kaluara, pjesën dërmuese e përbëjnë krimet e **trafikimit të lëndëve narkotike (106 procedime – 47%), shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë (41 procedime – 18%), trafikimi i qënieve njerëzore (28 procedime – 12,4%), vrasjet e kryera ndaj personave me cilësi të veçanta (14 procedime – 6,2%), trafikim i armëve dhe i municioneve (14 procedime – 6,2%), veprat e ndryshme penale të kryera nga organizata kriminale dhe grupe të strukturuar (12 procedime – 5,3%), rrëmbimi i personit (7 procedime – 3%).**

Analiza e të dhënave tregon se, në raport me vitin 2010, numri i procedimeve për trafikim të lëndëve narkotike mbetet gati i njëjtë (2 procedime më pak). Numri i procedimeve të regjistruara për trafikim të qënieve njerëzore, me një rritje të ndjeshme nga 2009-a në 2010-ën (nga 9 në 36 raste), pati një ulje të ndjeshme; gjatë vitit që shkoi u regjistruan vetëm 7 procedime penale. Pati një ulje të vogël numri i rasteve të shtrëngimit me anën e kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, duke zbritur në nivelin e vitit 2009. Edhe rastet e trafikimit të armëve dhe të rrëmbimit të personit patën rënie të dukshme në regjistrimet e vitit të kaluar. Tendencat për krime të kryera nga organizata ose grupe të strukturuar raportohet në rendin zbritës, vetëm 3 raste të regjistruara gjatë vitit 2011.

Në çështjet e dërguara për gjykim, sipas llojit të veprave penale, numrin më të madh të tyre (33 çështje ose 14 më shumë se vitin e kaluar) dhe të personave të akuzuar (57 të pandehur ose 4 më pak se vitin e kaluar) e përbëjnë, sikurse edhe vitet e kaluara, trafikimi i lëndëve narkotike.

Vërehet ulje e numrit të çështjeve të dërguara në gjyq për akuzat e trafikimit të njerëzve dhe të shtrëngimit për dhënien e pasurisë, ndërkohë që çështjet për vepra të tjera kanë gati të njëjtën dinamikë.

Gjatë vitit 2011, për dënimet me burgim vërehet e njëjta politikë dënimesh si në vitin e kaluar, pa ndryshime të ndjeshme, me një ashpërsim të dënimeve të dhëna nga gjykatat në rastet e akuzave për vrasje të cilësuar krahasuar me vitin 2010. Për krimet e trafikimit të njerëzve dhe të lëndëve narkotike, gjatë vitit 2011, vazhdoi e njëjta politikë dënimi, mjaft e ashpër për rastin e narkotikëve, për shkak të sanksioneve të larta që parashikon Kodi Penal.

Në kuadër të hetimeve të zhvilluara, është rritur numri i procedimeve penale ku janë aplikuar përgjimet telefonike në 70 (65 në vitin 2010 dhe 54 procedime gjatë 2009-ës). Janë dhënë 365 autorizime (103 më pak se vitin e kaluar) për përgjimin e 683 pajisjeve fundore (90 pajisje fundore më pak se në 2010-ën). Janë dhënë, gjithashtu, 30 autorizime për përgjime ambientale dhe 10 për në vende publike. Pavarësisht nga shifrat më të ulëta se viti i kaluar lidhur me numrin e pajisjeve fundore të vëna në përgjim, ato mbeten gjithësesi të larta në raport me numrin e procedimeve të ndjekura. Ashtu si përgjatë vitit 2010 veprimet teknike nuk po sjellin përmirësimin e pritjes të rezultateve, sidomos në hetimet për trafikim të lëndëve narkotike, si në drejtim të numrit të rasteve të dështuara, ashtu edhe në drejtim të rëndësisë së personave që hetohen.

Hetimet pasurore në zbatim të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009 òPër parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

Një nga prioritetet e prokurorisë ka qënë dhe zbatimi i kërkesave të ligjit òPër parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë. Strukturat përkatëse të ngritura pranë Prokurorisë për Krime të Rënda kanë funksionuar me kapacitet të plotë dhe efektivitet. Është rritur bashkëpunimi i kësaj strukture me policinë e shtetit, prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe partnerët ndërkombëtarë, me qëllim marrjen e informacioneve sa më të plota rreth pasurive të personave që dyshohet se janë përfshirë në krimin e organizuar, si dhe sekuestrimin e konfiskimin e kësaj pasurie. Janë organizuar trajnime të shumta të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe strukturave të tjera të përfshira në zbatimin e këtij ligji, me qëllim rritjen e efektivitetit të punës.

Gjatë vitit 2011 ka patur rritje të ndjeshme të numrit të rasteve të hetimit pasuror, të numrit të rasteve të dërguara në gjykatë për sekuestrim, të numrit të rasteve të konfiskuara me vendim gjykate. Rritja ka qënë jo vetem ne shifra absolute për numrin e rasteve të hetuara, por dhe në vlerën e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar. Gjatë vitit 2011 është arritur të merren 9 vendime gjykate për konfiskimin e pasurive të ndryshme.

Të dhënat statistikore, për zbatimin e ligjit òPër parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë gjatë vitit 2011, janë si më poshtë.

Kanë qënë në hetim 55 procedime pasurore, nga të cilat janë përfunduar 24 procedime. Në gjykatë janë dërguar 16 procedime pasurore dhe janë pushuar 8 procedime pasurore. Nga 16 procedimet e dërguara në gjykatë, në 5 raste janë është miratuar sekuestro nga gjykata, në 9

raste është miratuar konfiskimi nga gjykata dhe për 2 raste vazhdon gjykimi i kërkesës për konfiskim.

Në pesë raste janë sekuestruar pasuri të tilla si, gjashtë apartamente banimi me sipërfaqe rreth 390 m<sup>2</sup>, tokë "arë" me sipërfaqe rreth 4700 m<sup>2</sup>, pesë automjete të markave të ndryshme.

Në nëntë raste janë konfiskuar pasuri të tilla si, 2 815 648 Euro, 31 969 962 lekë, 5875 m<sup>2</sup> truall, dy apartamente banimi me sipërfaqe 205 m<sup>2</sup>, dy ambjente shërbimi òBar-Restaurant-Hotelò, me sipërfaqe ndërtimi 2921 m<sup>2</sup>, dy njësi tregëtare me sipërfaqe 138 m<sup>2</sup>, tre autovetura të markave të ndryshme me vlerë rreth 40 mijë Euro.

## **NJËSITE E PËRBASHKËTA HETIMORE**

Lufta kundër korrupsionit dhe veprave penale të lidhura me të ka qenë dhe mbetet prioritet i prokurorisë edhe për vitin 2011. Gjatë këtij viti, kemi vazhduar të punojmë në drejtim të forcimit dhe konsolidimit të Njësive të Përbashkëta Hetimore, si struktura të specializuara për ushtrimin e ndjekjes penale, në fushën e korrupsionit, krimit ekonomik, pastrimit të parave dhe krimit kompjuterik.

Prokuroria e Përgjithshme ka mbështetur me përparësi financiarisht dhe me mjete administrative këto struktura, kuptohet brenda mundësive që i lejon buxheti i institucionit. Janë kryer trajnime të shumta të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Njësive të Përbashkëta Hetimore, duke shfrytëzuar kapacitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, Policisë së Shtetit, si dhe projekteve të financuar nga donatorë të huaj ( MCC dhe OPDAT të financuara nga qeveria e SHBA, si dhe PACA dhe Projekti i Binjakëzimit me Spanjën të financuara nga Komisioni European).

Duke analizuar treguesit statistikore të punës rezulton se gjatë vitit 2011, Njësitë e Përbashkëta Hetimore kanë vendosur mosfillimin e procedimit penal për 392 kallzime penale, si dhe kanë patur në hetim 1165 procedime penale. Brenda vitit 2011 janë përfunduar 637 procedime penale, duke pushuar 351 procedime penale dhe dërguar për gjykim 286 procedime penale, me 485 të pandehur. Rezulton se janë dërguar për gjykim 45% e procedimeve të përfunduara, tregues pozitiv ky i punës së prokurorëve të Njësive.

Tregues pozitiv është dhe fakti se gjatë vitit 2011 janë regjistruar kryesisht nga prokurorët e Njësive të Përbashkëta Hetimore 80 procedime penale, nga 42 procedime të regjistruara kryesisht në vitin 2010. Rezulton një rritje gati 2 herë e numrit të procedimeve të regjistruara kryesisht nga prokurorët. Burimi i informacionit për të regjistruar këto procedime kanë qënë shtypi, mediat, shërbimet inteligjente, procedime të tjera në hetim nga ku janë konstatuar element për të filluar hetime të reja, etj.

Gjatë vitit 2011 kanë qënë në hetim 618 persona, nga të cilët për 564 janë përfunduar hetimet. Për të pandehurit që janë përfunduar hetimet është vendosur që 485 prej tyre të dërgohen për gjykim dhe për 79 të pandehur, të pushohen hetimet. Rezulton se janë përfunduar hetimet gjatë vitit 2011 për 91 % të personave të marrë të pandehur, duke pushuar akuzat për rreth 14 % të tyre dhe dërguar për gjykim rreth 86 % e tyre.

Gjatë vitit 2011 kanë qënë në gjykim 390 procedime penale me 742 të pandehur, nga të cilat për 196 procedime penale me 365 të pandehur ka përfunduar gjykimi. Gjykatat kanë shpallur fajtorë 311 të pandehur.

Gjatë vitit 2011 është ushtruar ndjekja penale dhe dhënë fajësi nga gjykata dhe ndaj 15 personave juridikë, për vepra penale të ndryshme. Kanë qënë 14 raste në Njësinë e Përbashkët Hetimore Shkodër dhe një rast në Njësinë e Përbashkët Hetimore Vlorë.

Vlerësojmë sidomos punën e mirë që prokurorët e Njërive të Përbashkëta Hetimore kanë bërë në kuadër të hetimit të veprës penale të pastrimit të parave, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Si rezultat i kësaj pune të mirë të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe koordinimit me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit është arritur që të përmirësohen ndjeshëm treguesit e ndjekjes penale për këtë vepër.

Në analizë të treguesve të punës së Njërive të Përbashkëta Hetimore rezulton se ka patur dhe probleme që kanë ndikuar në efektivitetin e punës së tyre. Konstatohet se ka ulje rrethe 50% të procedimeve penale të regjistruara për veprat penale të korrupsionit në krahasim me vitin 2010. Ky fakt ka ardhur kryesisht për shkak të uljes së numrit të referimeve nga policia gjyqësore për këto vepra penale.

Konstatohen probleme dhe pamundësi për të shfrytëzuar sa duhet metodat speciale të hetimit dhe kryer hetime proaktive, sidomos kjo në Njësitë e Përbashkëta në rrethe. Kjo për faktin se përqëndrimi i strukturave të specializuara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë e ka bërë të vështirë praktikisht shfrytëzimin e këtyre kapaciteteve teknike dhe mjeteve speciale të hetimit nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore në rrethe.

## **PASTRIMI I PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE**

Ushtrimi i ndjekjes penale ndaj autorëve që kryejnë òPastrimin e produkteve të veprës penale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ka vazhduar të jetë një prioritet i punës së prokurorisë edhe gjatë vitit 2011. Është punuar për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha strukturave të zbatimit të ligjit që merren me parandalimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale në këtë drejtim. Janë organizuar trajnime, takime pune, analiza, shkëmbyer informacione në mënyrë të vazhdueshme me të gjithë faktorët, me qëllim rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale ndaj kësaj veprë penale, me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Ndikim pozitiv ka dhënë edhe implementimi i Projektit të Binjakëzimit me autoritetet spanjolle dhe bullgare, i financuar nga Komisioni Evropian.

Treguesit e ndjekjes penale gjatë vitit 2011 kanë qënë në rritje sasiore, por kryesisht rritje cilësore. Rezulton se kanë qënë në hetim 102 procedime penale me 36 persona të pandehur. Janë përfunduar 44 procedime penale me 28 persona të pandehur. Nga procedimet penale të përfunduara 7 procedime me 16 të pandehur janë dërguar për gjykim, ndërsa 37 procedime penale me 12 të pandehur janë pushuar. Gjatë vitit 2011 janë dhënë dy vendime fajësie nga gjykatat për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Një rast në Tiranë dhe një rast në Vlorë.



Duke analizuar treguesit e mësipërm dhe krahasuar ata me treguesit e vitit 2010 rezultojnë se kemi përmirësim të ndjeshëm të punës së prokurorisë në këtë drejtim.

Gjatë vitit 2011 janë përfunduar hetimet për 6 procedime penale më shumë se në vitin 2010 (44 nga 38). Janë përfunduar hetimet për 20 të pandehur më shumë se në vitin 2010 (28 nga 8). Pra kemi rritje të procedimeve të përfunduara me rreth 16% dhe rritje të numrit të të pandehurve për të cilët është përfunduar hetimi me 2.5 herë.

Gjatë vitit 2011 janë dërguar për gjykim 4 procedime penale më shumë se në vitin 2010 (7 nga 3) dhe 13 të pandehur më shumë se në vitin 2010 (16 nga 3). Pra rezultojnë se kemi rritje të procedimeve penale të dërguar për gjykim me rreth 2 herë më shumë dhe rritje të numrit të pandehurve të dërguar për gjykim me rreth 5 herë.

Gjatë vitit 2011 janë dhënë dy vendime fajësie nga gjykatat për dy persona të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Vendimet e dënimit janë dhënë nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjykata e Vlorës ka vendosur edhe konfiskimin e tre apartamenteve, një njësi shërbimi dhe një garazh, të cilat u provuan se ishin produkt i veprës penale.

## VJEDHJET

Ky grup veprash penale kanë qenë në prioritetet e punës së organit të prokurorisë edhe për vitin 2011. Nga analiza e të dhënave statistikore për këtë grup veprash penale, vlen të theksojmë faktin se pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2011 është 41,1 % (për qind), për vitin 2010, pesha specifike e këtij grupi veprash penale ishte 39,95 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2011 në krahasim me vitin 2010.

Nga analiza e të dhënave statistikore rezultojnë se në vitin 2011 ka një rritje prej 5,21 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për grupin e veprave penale që lidhen me vjedhjen në krahasim me vitin 2010. Me rritje prej 5,29 % (për qind) rezultojnë të jenë edhe numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2010. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2010 prej 9,3 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 5,23 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 22,11 % (për qind) përkundrejt vitit 2010.

Organi i prokurorisë ka ashpërsuar politikën e dënimit ndaj autorëve të këtyre veprave penale. Ky qëndrim del qartë në pah në analizën e treguesve statistikore të kërkesave të prokurorëve për llojet dhe masat e dënimit. Kësaj politike dënimi edhe për vitin 2011 vlerësojmë se nuk i është përgjigjur me ashpërsinë e duhur gjykata, që përgjithësisht ka dhënë masa dënimi më të zbutura.

Edhe gjatë vitit 2011, vihet re rritje shqetësuese e numrit të procedimeve të pezulluara për të gjitha shkaqet që parashikon shprehimisht ligji (ku pjesën më të madhe e zënë pezullimet për omoszbulim të autorit të krimtës) për këtë grup veprash penale.

Kështu, nga të dhënat statistikore, ky tregues ndër vite rezulton të jetë: në vitin 2009 janë 4071 procedime të pezulluara, që do të thotë 68,84% e të gjitha procedimeve të pezulluara; në vitin 2010 janë 4992 procedime të pezulluara për moszbulim të autorëve të krimit, që dotë thotë 73,25% e të gjitha procedimeve të pezulluara dhe në vitin 2011 kjo e dhënë rezulton të jetë 5872 procedime, që do të thotë 74,36% (për qind) e të gjitha procedimeve të pezulluara gjatë vitit 2011.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



## SHKELJET E RREGULLAVE TË QARKULLIMIT RRUGOR

Vepra penale e parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal òShkelja e rregullave të qarkullimit rrugorë, në vitin 2011 ka qenë ndër prioritete e punës së organit të prokurorisë. Nga të dhënat statistikore, vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2011, prej 2,45% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Në vitin 2011 janë regjistruar 754 procedime penale, ndërkohë që në vitin 2010 janë regjistruar 773 procedime penale. Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale òKundër rendit dhe sigurisë publike është 26,41% (për qind) për vitin 2011, ndërkohë që në vitin 2010 ka qenë 28,6% (për qind).

Në lidhje me këtë vepër penale, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2011 ka një ulje të procedimeve penale të dërguara për gjykim prej 2,77% (për qind) në krahasim me vitin 2010; me ulje rezulton të jenë edhe numri i të pandehurve të regjistruar, prej 1,89% në vitin 2011 (568) në krahasim me vitin 2010 (579); ka një ulje të numrit të të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 4,9% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

## II. ANALIZË E TENDENCAVE TË KRIMINALITETIT PËR VITIN 2011

### II.1 TENDENCAT NË RRIJTJE:

#### a. Veprat penale kundër personit, “Krime kundër jetës të kryera me dashje”

- neni 78 ÷ Vrasja me paramendim
- neni 79 i Kodit Penal ÷ Vrasja në rrethana të tjera cilësuese
- neni 84 i Kodit Penal ÷ Kanosja

Lidhet me uljen e sigurisë publike në konsekuencë të ndikimit të faktorëve socialë dhe ekonomike, të brendshëm dhe të jashtëm. Në këto kushte, cmohet e domosdoshme rritja e bashkëpunimit të gjitha institucioneve ligjzbatuese për rritjen e zbulueshmërisë të autorëve të këtyre veprave penale dhe vënien e tyre para ligjit. Gjithashtu, është i nevojshëm dhe aplikimi i një politike penale më të ashpër ndaj këtyre individëve nga ana e sistemit të drejtësisë.

#### b. Veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit

- neni 88 i Kodit Penal ÷ Plagosje e rëndë me dashje
- neni 89 i Kodit Penal ÷ Plagosje e lehtë me dashje

Për këtë grup veprash penale tendenca përgjithësisht shpjegohet sikurse në rastin e veprave penale kundër personit, ÷ Krime kundër jetës të kryera me dashje.

#### c. Vjedhja

- neni 134 i Kodit Penal ÷ Vjedhja
- neni 139 i Kodit Penal ÷ Vjedhja me dhunë
- neni 141 i Kodit Penal ÷ Vjedhja me pasojë vdekjen

Në tendencën në rritje të këtij grup-veprash penale çmohet se kanë ndikuar faktorët socialo-ekonomikë dhe ulja vit pas viti e zbulueshmërisë së autorëve të tyre. Konstatohet rritje e numrit e të pandehurve të mitur për këtë grup veprash penale. Vlerësojmë që mungesa e një sistemi efikas për ndëshkueshmërinë penale ndaj kësaj kategorie individësh (konsideruar moshën, edukimin, kushtet e jetesës, prejardhjen familjare, etj.) është një faktor që ka ndikuar në rritjen e numrit të rasteve të këtij grupi veprash penale.

#### d. Mashtrimet

- Neni 143 i Kodit Penal ÷ Mashtrimi

Vlerësojmë se është një tendencë që lidhet me një orientim të një kategorie personash të shoqërisë shqiptare për t'u pasuruar në mënyrë të shpejtë dhe të kundraligjshme, me anë të formave të ndryshme të mashtrimit. Ndoshta është e nevojshme të bëhet një lloj sensibilizimi i opinionit publik për ndërgjegjësimin e publikut për të mos rënë pre e këtyre formave.

**e. Shkatërrimi i Pronës**

- neni 151 i Kodit Penal ÷Shkatërrimi i pronës me zjarrë
- neni 152 i Kodit Penal ÷Shkatërrimi i pronës me eksplozivë
- neni 155 i Kodit Penal ÷Shkatërrimi i rrugëve
- neni 156 i Kodit Penal ÷Shkatërrimi i rrjetit elektrikë

Jemi të mendimit se tendenca e shfaqur për këtë grup veprash penale lidhet me uljen e sigurisë publike dhe me shkallën e ulët të zbulueshmërisë së autorëve të këtyre veprave penale.

**f. Krime Kundër Mjedisit**

- neni 205 i Kodit Penal ÷Prerja e paligjshme e pyjeve
- neni 206/a i Kodit Penal ÷Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë
- neni 206/b i Kodit Penal ÷Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarrë i pyjeve

Tendenca për këtë grup veprash penale mendojmë se ka lidhje me evidentimin dhe me administrimin më të mirë të kësaj forme kriminaliteti nga strukturat përgjegjëse.

**g. Veprat Penale Kundër Rendit Dhe Sigurisë Publike**

- neni 273 i Kodit Penal ÷Largimi nga vendi i aksidentitë
- neni 274 i Kodit Penal ÷Prishja e qetësisë publike
- neni 275 i Kodit Penal ÷Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike
- neni 278 i Kodit Penal ÷Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionitë
- neni 279 i Kodit Penal ÷Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta
- neni 291 i Kodit Penal ÷Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmië

Nga ky grup veprash penale, me tendencë më të lartë në rritje paraqiten veprat penale të parashikuara nga nenet 275 dhe 279 i Kodit Penal. Konstatohet se në lidhje me nenin 275 ÷Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike ka ndikuar në rritjen e numrit të tyre mungesa e zbulueshmërisë së autorëve të këtyre veprave edhe për shkak të faktit se është e pamundur të identifikohet personi i cili është përdoruesi i një numri telefonik me gjithë parashikimet që ka bërë ligji ÷Për telekomunikacionin. Në hetimet e këtyre çështjeve, rëndom ndeshemi me fenomenin kur një individ blen nga kompanitë celulare numër të madh pajisjesh fundore të cilat i shet më pas në tregun informal pa identifikuar përdoruesin e fundit, sic është për shembull rasti i një individi në Tiranë, i cili rezultoi se ka blerë nga dy shoqëritë telefonike 13932 pajisje fundore. Gjykojmë se është imediate ndërhyrja në legjisalcion për zgjidhjen e kësaj problematike.

Përsa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 279 ÷Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta i Kodit Penal është më shumë e pranishme në ambjentet e institucioneve arsimore, prandaj duhet punuar edhe në këtë drejtim.

#### **h. Veprat penale që lidhen me zhvillimin e palejuar të lojrave të fatit**

- neni 197 i Kodit Penal ÷Organizimi i llotarive të palejuara÷

Të dhënat statistikore edhe për vitin 2011, tregojnë tendencë në rritje të veprës penale ÷Organizimi i llotarive të palejuara÷, neni 197 i Kodit Penal. Kjo vepër, ndonëse nuk zë ndonjë peshë të madhe specifike, për shkak të pasojave ekonomike që i sjell shtetit nga evazioni fiskal që krijohet, tërheq vëmendjen për shtrirjen e saj pothuajse të njëtrajtshme në të gjithë territorin e Republikës.

Vlerësojmë se si shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale si dhe pesha specifike që ajo zë në nuk përfaqëson realitetin e përhapjes së kësaj vepre penale dhe për këtë shkak puna jonë në të ardhmen do të orientohet në drejtim të evidentimit të aktivitetit kriminal që kryhet në këtë fushë duke forcuar bashkëpunimin me strukturat e tjera kompetente në këtë fushë.

#### **i. Veprat penale që lidhen me kultivimin dhe prodhimin e narkotikëve**

- neni 283 i Kodit Penal ÷Prodhimi dhe shitja e narkotikëve÷

Konstatojmë se ka tendencë rritje vepra penale e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal ÷Prodhimi dhe shitja e narkotikëve÷. Në të shumtën e rasteve rezulton se personat që kryejnë këtë vepër penale janë njëkohësisht edhe përdorues dhe ky fakt na sjell në vëmendje nevojën për ndërhyrje në këtë dispozitë në Kodin Penal në mënyrë që të qartësohen kushtet e përgjegjesisë penale për përdoruesit dhe masa e dënimit për to.

## **II. 2 TENDENCAT NË ULJE:**

Rezulton nga të dhënat statistikore se:

#### **a. Veprat penale në lidhje me doganat**

- neni 172 i Kodit Penal ÷Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë÷
- neni 174 i Kodit Penal ÷Kontrabanda me mallrat të tjera÷

Në uljen e procedimeve të regjistruara për këto dy vepra penale mendojmë se ka ndikuar miratimi i ligjit nr.10418, datë 21.4.2011 ÷Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor÷.

#### **b. Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë**

- neni 186 i Kodit Penal ÷Falsifikimi i dokumenteve÷
- neni 191 i Kodit Penal ÷Falsifikimi i akteve të gjendjes civile÷

Vlerësojmë se shkak për këtë tendencë në ulje të këtyre veprave penale edhe për vitin 2011 është ulja e nevojës së përdorimit të një kategorie dokumentesh pas futjes në qarkullim të kartave të identitetit dhe i pasaportave biometrike.

#### **c. Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet**

- neni 181 i Kodit Penal ÷ Mospagimi i taksave dhe tatimeve

Sikurse në rastin e kontrabandës edhe për edhe për këtë vepër penale ka ndikuar në uljen e procedimeve të regjistruara, miratimi i ligjit nr.10418, datë 21.4.2011 ÷ Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganorë.

#### **d. Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim public**

- neni 248 i Kodit Penal ÷ Shpërdorimi i detyrës
- neni 250 ÷ Kryerja e veprimeve arbitrare

Në lidhje me tendencën në ulje të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal ÷ Shpërdorimi i detyrës, konstatohet se nuk i përgjigjet realitetit. Ky tregues vjen si rrjedhojë e uljes së referimeve nga Policia e Shtetit, si dhe e uljes së kallëzimeve nga organet e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm financiar për këtë vepër penale.

#### **e. Veprat penale në lidhje me trafiket e qënieve njerëzore**

- neni 110/a i Kodit Penal ÷ Trafikimi i personave
- neni 114/b i Kodit Penal ÷ Trafikimi i femrave
- neni 128/b i Kodit Penal ÷ Trafikimi i të miturve

Tendenca në ulje e këtyre grup veprave penale, vlerësojmë që është një element real që ka ardhur si pasojë e goditjes së ashpër të këtij lloj kriminaliteti në mënyrë të vazhdueshme, si dhe sensibilizimit të vazhdueshëm të shoqërisë për të mos u bërë pre e këtij lloj fenomeni.

#### **e. Veprat penale kundër korrupsionit**

- neni 245/1 ÷ Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike
- neni 259 i Kodit Penal ÷ Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Në lidhje me tendencën në ulje të procedimeve penale të regjistruara për këto vepra penale konstatohet se nuk i përgjigjet realitetit. Ky tregues vjen si rrjedhojë e uljes së referimeve

kryesisht nga Policia e Shtetit, si dhe mosndëshkueshmëria në mënyrën e duhur nga sistemi gjyqësor për raste për të cilat është ngritur akuzë dhe është dërguar çështja në gjykatë.


#### **f. Veprat penale që lidhen me krimin kompjuterik**

Tërheqim vëmëndjen në lidhje me këtë grup veprash penale të cilat pavarësisht se tregojnë një tendencë në ulje duhet të trajtohen me shumë vëmëndje nga të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit për shkak të faktit se kanë një tendencë në rritje në të gjitha vendet e zhvilluara evropiane dhe së dyti, në mënyrë të vazhdueshme në vendin tonë po rritet numri i përdoruesve të internetit, elementë që natyrshëm të cojnë në konkluzionin që ky lloj kriminaliteti duhet të jetë në tendencë rritje.


### **III. ANALIZË E DISA TREGUESVE NË RITJE TË NDJEKJES PENALE NË HETIMET PARAPRAKE DHE NË GJYKIM**

- Të dhënat statistikore në pesë vitet e fundit evidentojnë tregues në rritje, si të volumit të punës dhe të cilësisë, ashtu dhe treguesit me sintetik në rritjen e efektivitetit dhe forcimin e ligjshmërisë, në ushtrimin e ndjekjes penale në hetimet paraprake dhe ngritjen e përfaqësimit e akuzës në emër të shtetit në gjykat. Në vitin 2007 është ngritur akuzë në gjykatë për rreth 81% të pandehurve ndaj të cilëve kanë përfunduar hetimet paraprake. Kjo shifër për vitet 2008, 2009 është rritur në rreth 86%, ndërsa në vitet 2010 e 2011 është rreth 82 %.
- Gjithashtu, evidentohet rritje e numrit të personave ndaj të cilëve është ngritur akuzë në gjykatë dhe që janë deklaruar fajtorë e dënuar nga gjykata, si dhe ulja e numrit të personave të deklaruar të pafajshëm nga gjykata, tregues që evidentojnë rritjen e efektivitetit dhe ligjshmërisë në përfaqësimin e akuzës në gjykim. Në vitin 2007 janë deklaruar fajtorë dhe dënuar 86.7% e personave që ka përfunduar gjykimi, raport i cili në vitet 2008, 2009 e 2010 është 96.2 % dhe në vitin 2011 është 97.1 %. Ndërsa, në vitin 2007 janë deklaruar të pafajshëm 2.58% e personave që ka përfunduar gjykimi, raport i cili në vitin 2008 është 2.47%, në vitin 2009 është 3.23%, në vitin 2010 është 2.97% dhe në vitin 2011 është 2.62 %.
- Nga analiza e treguesve statistikore evidentohet se organi i Prokurorisë ka qënë i orientuar drejt një politike të ashpër dënimi në kërkesat që janë paraqitur në gjykatë për dënimin e autorëve të veprave penale. Kjo politikë e ashpër dënimi spikat veçanërisht ndaj autorëve të veprave penale që rezultojnë me tendencë në rritje, si dhe ndaj autorëve të veprave penale që janë konsideruar prioritet i punës së organit të akuzës. Krahasimi i të dhënave statistikore evidenton se në ndryshim nga qëndrimi i organit të akuzës në drejtim të politikës së dënimit, përgjithësisht gjykatat e të gjitha niveleve kanë aplikuar lloje dhe masa dënimi më të buta se ato të kërkuara nga prokurorët.

**KËRKESA E PROKURORIT PËR DËNIME ME BURGIM NË MINIMUM**




**KËRKESA E PROKURORIT PËR DËNIME ME BURGIM MESATAR**







**KËRKESA E PROKURORIT PËR DËNIME NË MAKSIMUM**




**KËRKESA E PROKURORIT PËR BURGIM TË PËRJETSHËM**



**KËRKESA E PROKURORIT PËR PEZULLIM TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT ME BURGIM DHE VËNIA NË PROVË, NENI 59**



**KËRKESA E PROKURORIT PËR DËNIME ME BURGIM**



- Analiza pesëvjeçare e treguesve të procedimeve penale të përfunduara në hetimet paraprake evidenton tendencë në rritje, vit pas viti, të numrit të procedimeve penale të pezulluara për moszbulim të autorëve, nga 4334 procedime të pezulluara në vitin 2007 në 7906 procedime të pezulluara në vitin 2011 ose me rritje 83 % të tyre. Ndërsa, krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010, evidentohet rritje 15.87 % të numrit të procedimeve të pezulluara për moszbulim të autorit. Në analizë të këtij treguesi, për vitin 2011 evidentohet përhapja dhe shtrirje e procedimeve të pezulluara për vepra penale të veçanta apo për grupvepra dhe me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si më poshtë:
- 5116 procedime të pezulluara ose 65% e totalit të procedimeve penale të pezulluara, i përkasin veprës penale të vjedhjes së pasurisë parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal *÷Vjedhja*;
  - 413 procedime të pezulluara ose 6% e totalit të procedimeve të pezulluara i përkasin veprës penale të parashikuar nga neni 137 *÷Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike*;
  - 369 procedime të pezulluara, ose 4.5% e totalit të procedimeve të pezulluara i përkasin veprave penale *÷Shkatërrimi i pronës me zjarrë*, *÷shkatërrimi i pronës me eksplozivë* dhe *÷shkatërrimi me zjarre i pyjeve dhe mjedisit pyjor*, ÷ të parashikuar nga nenet 151, 152 e 206 të Kodit Penal;
  - 223 procedime të pezulluara ose 2,28% e totalit të procedimeve të pezulluara i përkasin veprave penale *÷Vjedhja me dhunë*, *÷Vjedhje me armë* të parashikuar nga nenet 139, dhe 140 të Kodit Penal;
  - 146 procedime të pezulluara ose 1.8 % e totalit të procedimeve të pezulluara i përkasin veprave penale *÷Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugorë* dhe *÷Largim nga vendi i aksidentit* të parashikuar nga nenet 290 e 291 të Kodit Penal;
  - 107 procedime të pezulluara ose 1.35 % e totalit të procedimeve të pezulluara i përkasin veprave penale *÷Vrasje me dashje*, *÷Vrasje me paramendim* dhe *÷Vrasje në rrethana tjera cilësuese*, të parashikuara nga nenet 76, 78 e 79 të Kodit Penal;
  - 210 procedime të pezulluara ose 2,65% e e totalit të procedimeve penale të pezulluara i përkasin veprës penale të parashikuar nga neni 141/a *÷Trafikimi i mjeteve motorike*;
  - 70 procedime penale të pezulluara ose 0,88% (për qind) e totalit të procedimeve të pezulluara i përkasin veprës penale të parashikuar nga neni 284 *÷Kultivimi i bimëve narkotike*.

Kjo gjendje e procedimeve penale të pezulluara për moszbulim të autorëve, me shifra në rritje vit pas viti, edhe për vitin 2011, evidenton mangësi në zbulimin e autorëve nga strukturat përkatëse të shërbimeve të policisë së shtetit, si dhe nevojën për përmirësimin rrënjësor të punës nëpërmjet hartimit të një strategjie për të luftuar këtë fenomen në të gjithë dimensionet e tij. Gjithashtu, çmujmë se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të organizojë kontrole dhe analiza në të gjitha strukturat e shërbimeve të policisë gjyqësore në policinë e shtetit, me qëllim për të analizuar gjëndjen e veprave penale të pazbuluara, si dhe për të rritur angazhimin dhe përgjegjshmërinë e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore në të gjithë nivelet në ushtrimin e funksioneve të tyre, për kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave, njoftimeve dhe provave, për gjurmimin dhe zbulimin e autorëve të veprave penale të pezulluara/pazbuluara.

#### IV. REFORMIMI I PROKURORISË, RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA DHE ME MISIONET NDËRKOMBËTARE

##### REFORMIMI I PROKURORISË

Prokuroria shqiptare krahas punës së saj të përditshme në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimit e akuzës në gjyq në emër të shteti, është angazhuar seriozisht dhe në pëmirësimin e treguesve të tjerë të punës, të cilët në mënyrë integrale janë pjesë e funksioneve të saj kushtetuese. Në këtë kontekst është konsideruar në mënyrë të vazhdueshme, reformim i brendshëm, si një element vital për mirëfunksionimin e institucionit. Në këtë drejtim, duke shfrytëzuar asistencën e partnerëve ndërkombëtarë edhe të misioneve të huaja që asistojnë e mbështesin punën e prokurorisë, janë miratuar një sërë aktesh normative të cilat janë të drejtuara drejt vendosjes së rregullave për funksionimin e brendshëm të institucionit dhe rritjes së transparencës në aktivitetin e tij. Miratimi i këtyre akteve është bërë duke u mbështetur në ligjin organik të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë dhe në rekomandimin nr. 19/2000 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, rekomandimet e Raport-progresit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2010.

**Gjatë vitit 2011 janë miratuar akte normative të Prokurorit të Përgjithshëm si:**

1. Urdhrin nr.38 datë 09.03.2011, òPër listen e dokumentave të klasifikuara òSekret Shtetërorò në Prokurorinë e Përgjithshmeò.
2. Urdhrin nr.191 datë 27.10.2011 òPër shërbimin e gatishmërisë në prokuroriò, i cili ka për qëllim rregullimin më të mirë të raporteve që krijohen në funksion të realizimit të detyrave të ngutshme që lidhen me hetimin dhe ndjekjen penale në përgjithësi, duke mbajtur në gjendje gatishmerie burimet njerëzore (*prokurorin dhe strukturat ndihmëse*) dhe infrastrukturën, për të bërë të mundur zgjidhjen në kohë të problematikave të ngutshme të ndjekjes penale, si dhe parashikon kriteret objektive për ndarjen e çështjeve në prokurori në përputhje me grafikun e gadishmërisë.

Në zbatim të ligjit nr. 8677, datë 02.11.2000 òPër organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësoreò, të ndryshuar, Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit 2011, nën asistencën e vazhdueshme të EURALIUS, ka përgatiturtë gjitha projektaktet nënligjore, nëpërmjet të cilëve është synuar garantimi i efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së policisë gjyqësore, si subjekt i procedimit penal.

3. Udhëzimi nr. 1 datë 19.09.2011 òPër përcaktimin e kriterëve për shpërblimin për merita profesionale të oficerëve të Policisë Gjyqësoreò dhe Urdhëri Nr.165 datë 19.09.2011 òPër përcaktimin e kriterëve për dhënien e shtesës së pagës për vështirësi pune për oficerët e Policisë Gjyqësoreò, i cili ka për qëllim të individualizojë sektorët që kanë vështirësi më të madhe pune dhe t'u akordojë për këtë shkak, shtesën prej 20% të pagës. Të dy këto akte synojnë që nëpërmjet akordimit të stimulit financiar, t'i motivojë

oficerët e Policisë Gjyqësore në përmirësimin e punës së tyre në funksion të përmbushjes së misionit për luftën kundër kriminalitetit dhe parandalimit të tij.

4. Udhëzimi i përbashkët ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, nr.2, datë 07.11.2011 òPër kryerjen dhe perfundimin e hetimeve të kallzuara drejtpërdrejtë në Prokurori apo të filluara kryesishtò, i cili synon të disiplinojë kufijtë e delegimit të detyrave nga Prokurori tek Oficeri i Policisë Gjyqësore por edhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet tyre në zbatimin e detyrave funksionale, sipas rolit dhe përgjegjësisë të ndara, duke përcaktuar rregulla të hollësishme mbi përfundimin e veprimeve hetimore, delegimin e hetimeve nga ana e prokurorit, krijimin e grupeve hetimore të përbashkëta si dhe njohjen e prokurorit me organizimin e shërbimit të Policisë Gjyqësore.
5. Udhëzimi i përbashkët ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, nr.3, datë 15.12.2011 òPër procedimin disiplinor të punonjësve të Policisë Gjyqësoreò, i cili vendos rregulla për veprimtarinë e komisionit disiplinor që shqyrton procedimin disiplinor ndaj punonjësve të Policisë Gjyqësore në rastet dhe me garancitë e dhëna në ligj duke iu nënshtruar parimeve të ligjshmërisë, objektivitetit dhe kontradiktoritetit.
6. Marreveshje e përbashkët ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrave që kanë në varësi forca policore, òPër Trajnimin Vazhdues të Oficerëve dhe Agjentëve të Policisë Gjyqësoreò, e cila ka për qëllim ngritjen e vazhdueshme profesionale të oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore duke e vlerësuar këtë si një nevojë të domosdoshme në luftën kundër kriminalitetit, në përmirësimin e procesit hetimor të veprave penale dhe në garantimin më të mirë të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.
7. Udhëzimi i përbashkët, ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrave që kanë në varësi polici gjyqësore, òPër procedurat e konkurrimit për caktimin në seksion të oficerëve të Policisë Gjyqësoreò. Ky udhëzim synon të detajojë rregullat e procedurës konkurruese, kushtet dhe kriteret e paraqitjes, përzgjedhjes, verifikimit dhe testimit të kandidaturave për oficerë të Policisë Gjyqësore. Meritokracia që synohet të arrihet në procesin rekrutues, do të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë në cilësinë e hetimit, në paanshmërinë dhe objektivitetin e kryerjes së veprimtarisë procedurale.
8. Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm, òPër mënyrën e vlerësimit të rezultateve individuale në punë të oficerëve të seksioneve të Policisë Gjyqësoreò, i cili synon rritjen e përgjegjësisë së oficerëve të Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre, promovimin e qëndrueshmërisë në detyrë të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe marrjen e masave disiplinore ndaj atyre që vlerësohen të paaftë, si dhe identifikimin e mangësive profesionale dhe nevojat për trajnimin e tyre.
9. Urdhër i Përbashkët, ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrave që kanë në varësi polici gjyqësore òPër Përcaktimin e Organikës në Seksionet e Policisë Gjyqësoreò, i cili rishikohet çdo dy vjet, duke mbajtur parasysh numrin e prokurorëve dhe të personelit të policëve në shërbim, nevojat dhe kërkesat për luftën kundër

kriminalitetit, duke i shërbyer në këtë mënyrë bashkëveprimit institucional dhe cilësisë së hetimit.

### **FORCIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM.**

Kontrolli i brendshëm i prokurorive të rretheve gjyqësore dhe atyre të apeleve, me synim mbikqyrjen e ushtrimit të funksioneve të tyre në zbatimin e Kushtetutës, ligjit dhe akteve normative të Prokurorit të Përgjithshëm, ka qenë një ndër prioritet e punës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme në përmbushje të këtij funksioni, për vitin 2011 kanë ushtruar kontrole të përgjithshme, të pjesshme, për grup çështjesh dhe për çështje të veçanta.

Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2011, ka përfunduar kontrollin e përgjithshëm mbi veprimtarinë e punës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Apeli Tiranë dhe Prokurorisë për Krimet të Rënda.

Ndërsa në disa prokurori të tjera janë bërë kontrole të pjesshme, bazuar në informacionet të ardhura nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale, Drejtorisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme si dhe ankesave të qytetarëve.

Janë bërë kontrole për prokurorë të vecantë, në prokurorinë e rrethit Tiranë dhe Elbasan.

Në total janë kontrolluar 1823 procedime penale, vendime mosfillimi, dosje të gjykuara dhe masa sigurimi në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe në Prokurorite e Apeleve. Pas kontrollit të kryer për këto procedime penale, është vendosur shfuqizimi për 6 vendime pushimi dhe 1 vendim mosfillimi.

Gjithashtu është vendosur për të filluar procedimi disiplinor për 5 prokurorë të shkallës së parë dhe të apelit. Në përfundim të procesit disiplinor nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm janë dhënë 4 masa disiplinore ÷vërejtje dhe një masë ÷ulje në detyrë për 18 muaj.

Në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, nga ana e Drejtuesve të Prokurorisë dhe prokurorët është kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme për veprimet e oficerëve të policisë gjyqësore gjatë kryerjes së hetimeve paraprake në procedimet penale. Gjatë dinamikës së kontrollit të hetimeve janë konstatuar zvarritje në hetime, veprimeve që janë kryer në shkelje të Kodit të Procedurës Penale etj.

Për këto shkelje janë filluar 18 procedime disiplinore, për 16 oficerë të policisë gjyqësore. Në përfundim të procesit janë vendosur: 5 ÷vërejtje me paralajmërim, 9 ÷vërejtje, 2 ÷pezullime nga detyra dhe 2 ÷ulje në detyrë

## FORCIMI I KAPACITETEVE NË ORGANIN E PROKURORISË.

Forcimi i kapaciteteve në prokurori si prioritet i punës sonë, është realizuar nëpërmjet përmirësimeve strukturore dhe rritjes profesionalizmit dhe profilizimit të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës për të rritur efektivitetin në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore.

- Edhe gjatë vitin 2011 ka vazhduar eksperiencia pozitive në lidhje me trajnimet e përbashkëta të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit. Këto trajnime kanë synuar rritjen e kapaciteteve profesionale, unifikimin e qëndrimeve përsa i përket problematikave të caktuara ligjore apo tipologjive të ndryshme të aktiviteteve kriminale. Gjatë këtij viti janë kryer 8 sesione trajnuese në disa Drejtori të Policisë, ku kanë marrë pjesë, 40 prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore nga prokuroria dhe 80 punonjës të shërbimeve të policisë së shtetit.
- Në Sektorin e Përgjimeve që funksionon në Prokurorinë e Përgjithshme është bërë riorganizimi i tij me qëllim rritjen e efektivitet në ndjekjen e proceseve hetimore në dinamikë dhe në konkludimin me sukses të hetimeve proaktive. Në funksion të këtij qëllimi është ngritur dhe ka filluar nga funksionimi Zyra e Sektorit të Përgjimeve pranë Prokurorisë për Krime të Rënda e cila është pajisur edhe me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të realizuar këtë proces.
- Në mënyrë të veçantë procesi i rritjes së kapaciteteve është fokusuar në trajnimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore janë realizuar me mbështetjen dhe kujdesin e Shkollës së Magjistraturës, Akademisë së Policisë, Misioneve ndërkombëtare OPDAT, EURALIUS, Projekti PACA, CPS-Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës (Britania e Madhe), Guardia di Finanza etj.

## MARRËDHËNIET E PROKURORISË ME INSTITUCIONET E TJERA

Në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit, për përmbushjen e misionit të saj, Prokuroria ka ndërtuar marrëdhënie me të gjitha institucionet dhe hallkat e pushteteve.

- Marrëdhëniet me institucionin e Presidentit të Republikës, kanë qenë dhe janë institucionale, në mbështetje të reformës në organin e prokurorisë dhe të veprimtarisë së saj. Në vitin 2011, Presidenti i Republikës ka dekretuar emërimet në detyrë të prokurorëve të rinj, transferimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve, në përgjigje të propozimeve të dërguara nga Prokurori i Përgjithshëm. Gjithashtu, institucioni i Presidentit të Republikës është informuar në vazhdimësi për konkluzionet e kontrolleve të ushtruara në organin e prokurorisë dhe problematikat e konstatuara në funksionimin e sistemit të drejtësisë.

- Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë janë të ndërtuara në linja institucionale dhe korrekte. Kuvendi ka miratuar pjesërisht kërkesat tona për rritjen e buxhetit. Sjellim në vëmendje tuaj dhe kërkojmë mbështetjen e Kuvendit në drejtim të:
  - Rritjes së fondeve buxhetore dhe garantimi i pavarësisë në menaxhimin e tyre si nevojë e domosdoshme e institucionit për ushtrimin e funksioneve kushtetuese.
  - Amendimeve të nevojshme ligjore me qëllim kufizimin e imuniteteve për t'ia hapur rrugë organit të akuzës që të ushtrojë më me efektivitet ndjekjen penale edhe për këtë kategori personash, veçanërisht në drejtim të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve në detyrë.
  - Amendimeve të nevojshme ligjore me qëllim dhënien e së drejtës Prokurorit të Përgjithshëm për të vënë në lëvizje kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë me synim unifikimin e praktikave gjyqësore, si dhe të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që janë në juridiksionin e kësaj Gjykate.
  - Ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme ligjore në Kodin Penal për të qartësuar dhe plotësuar formulimet e dispozitave për parashkrimin e ndjekjes penale dhe për parashkrimin e ekzekutimit të vendimeve, nenet 66 dhe 68 të Kodit Penal.
  - Ndërhyrje në Kodin e Procedurës Penale me qëllim pezullimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale për personat me imunitet, përsa kohë e gëzojnë këtë status.
  - Angazhimin e Kuvendit në miratimin e ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale pas propozimeve që do të vijnë nga grupet e punës për reformimin e tij, pjesë të cilëve janë edhe përfaqësues të prokurorisë.
- Në marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave, Prokuroria ka orientuar punën e saj duke ndjekur në dinamikë, prioritetet e shpallura prej qeverisë për luftën ndaj kriminalitetit. Aspekt tjetër i marrëdhënieve me Këshillin e Ministrave është dhe angazhimi i përfaqësuesve të prokurorisë në kuadrin e proceseve integruese të Shqipërisë në BE, në bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Integritit, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë etj. Në këtë kuadër vlen të veçohet bashkëpunimi me Departamentin Antikorrupsion në lidhje me hartimin e strategjisë afatmesme antikorrupsion si dhe në kudër të hartimit të planit të veprimit në zbatim të Rekomandimit nr.8 të Komisionit Evropian òlufta kundër korrupsionitò.
- Marrëdhëniet me Ministrinë e Brendshme janë karakterizuar nga fryma e bashkëpunimit të ndërsjelltë për zbatimin e ligjit dhe akteve normative të përbashkëta. Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe shërbimet e policisë gjyqësore në varësi të saj, vlerësohet si shumë i rëndësishëm në efektivitetin e punës së organit të prokurorisë dhe në mënyrë të veçantë në cilësinë e hetimit.
  - Krahas arritjeve, në marrëdhëniet me shërbimet e policisë gjyqësore në policinë e shtetit, vazhdon të evidentohet shqetësimi lidhur me nivelin profesional dhe paqëndrueshmërinë në detyrë të oficerëve të shërbimeve të policisë, faktorë të cilët kanë ndikuar qoftë në cilësinë ashtu dhe në mbarëvajtjen e hetimeve.



- Vihet re tendencë në ulje e referimeve të ardhura në prokurori nga Policia e Shtetit për vitin 2011 tek e cila do të veconim tendencën në ulje të referimeve për veprat penale në lidhje me korrupsionit dhe trafikut të narkotikëve.
  - Vazhdon të ketë probleme në lidhje me zbulimin e krimeve të rënda siç janë vrasjet dhe ato të vjedhjes, që kanë tendencë në rritje. Vlerësojmë se ka mangësi të theksuara në grumbullimin e informacioneve operative cilësore dhe të besueshme në terren nga ana e strukturave përgjegjëse të policisë së shtetit, drejtim në të cilin duhet të punohet më me seriozitet dhe profesionalizëm.
  - Ka rezultuar problematike përqëndrimi i veprimtarisë operacionale në një strukturë të posacme në nivel kombëtar dhe e pozicionuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ky lloj organizimi ka bërë të vështirë reagimin në kohën dhe mënyrën e duhur të strukturave të policisë së shtetit ndaj kërkesave të prokurorisë për përdorimin e metodave speciale të hetimit. Një riorganizimi i ndryshëm i kësaj strukture cmojme se do të jetë në ndihmë të rritjes së efikasitetit të përdorimit të metodave speciale të hetimit, vecanërisht në hetimin e krimet të organizuar dhe korrupsionit.
  - Bashkëpunim i frutshëm me Policinë e Shtetit ka vijuar edhe gjatë vitit 2011 në grupet e përbashkëta të punës në hartimin e akteve nënligjore të përbashkëta në zbatim të ligjit për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore (i ndryshuar).
- Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë për shkak të parashikimeve ligjore janë të orientuara në disa drejtime.
- Gjatë vitit 2011 Ministria e Drejtësisë ka ushtruar kontroll tematik për çështje të veçanta në 15 prokurori të rretheve gjyqësore për një total prej 36 çështje, kur për asnjë prej këtyre inspektimeve nuk ka paraqitur ndonjë vrejtië për punën e kryer nga ana e prokurorëve.

Gjithashtu gjatë vitit 2011, Ministria e Drejtësisë ka bërë kontroll në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për periudhën 2008-2010. Kontrolli u ushtrua mbi 76 çështje penale, nga të cilat 64 janë përfunduar me vendim pushimi dhe për 12 është vendosur mosfillimi i procedimit. Ky kontroll përfshin veprimtarinë e 18 prokurorëve. Nga 76 çështje të inspektuar kanë rezultuar (sipas inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë) me shkelje sipas ligjit 27 procedime.

Pas verifikimit të kryer nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme për raportin e dërguar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, shkeljet e ngritura vetëm në një rast kanë ndikuar në një vendimmarrje të gabuar, për të cilën është vendosur shfuqizimi i vendimit të pushimit. Për shkeljet e tjera të pretenduara edhe kur ato janë konstatuar si të sakta nuk kanë qenë të tilla që të kenë ndikuar në vendimmarrjen për zgjidhjen e çështjes. Cmojmë të nënvizojmë faktin se një pjesë e pretendimeve të Ministrisë së Drejtësisë të bëra prezent në raportin e kontrollit dhe që lidhen me shkeljet e kryera nga prokurorët në fazën e hetimeve paraprake janë në kapërcim të kompetencave që ka Ministria e Drejtësisë për kontrollin që ushtron në prokurori pasi lidhen me vlerësimin e bazueshmërisë në ligj të vendimmarrjes së prokurorit, kompetencë e cila i takon

kontrollit gjyqësor dhe kontrollit të prokurorit më të lartë. Ky qëndrim i është bërë prezent vazhdimisht Ministrisë së Drejtësisë në rrugë zyrtare.

- Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritet e huaja ka qenë korrekt, efikas dhe i frutshëm duke i shërbyer mirëfunksionimit të institucioneve shtetërore shqiptare në raport me homologët e huaj.
  - Në kuadër të reformës për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, me ftesën e Ministrisë së Drejtësisë jemi bërë pjesë e grupeve të punës për rishikimin e këtij Kodi.
- Marrëdhëniet me Shërbimin Informativ Shtetëror, edhe për vitin 2011, janë të fokusuara kryesisht në marrjen e informacionit nga ky shërbim në funksion të rritjes së efektivitetit në ndjekjen penale, veçanërisht në kuadër të veprave penale të krimit të organizuar dhe terrorizmit, trafikeve të paligjshme dhe korrupsionit. Informacionet e përcjella nga SHISH kanë rezultuar të vlefshme dhe na kanë orientuar drejt në nisjen e procedimeve penale veçanërisht nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore.
  - Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Drejtësisë konsiderohen pozitive dhe në vitin 2011, janë pasqyruar në procesin e dhënies së autorizimit për procedim penal ndaj gjyqtarëve për të gjitha rastet e kërkuara nga ana jonë. Gjithashtu kemi dërguar informacion dhe përcjellë shqetësim për rastet e shkeljeve në detyrë të gjyqtarëve dhe jemi në pritje të përgjigjeve.
  - Në marrëdhëniet e prokurorëve me sistemin gjyqësor kemi synuar të respektojmë me rigorozitet pavarësinë dhe paanësinë e gjykatave. Kemi synuar dhe synojmë që prokurorët të jenë profesionalë, objektivë dhe të ndershëm gjatë procedurave gjyqësore, veçanërisht duke siguruar që gjykatës t'ia jenë paraqitur të gjitha faktet që kanë lidhje me akuzën e ngritur dhe argumentat ligjore të nevojshëm për administrimin e duhur të drejtësisë.

Konstatojmë se drejtuesit e prokurorive nëpër rrethe kanë një raport të mirë bashkëpunimi me drejtuesit e gjykatave nëpër rrethe përse i përket menaxhimit të procesit administrativ të shpërndarjes së çështjeve apo respektimit të afateve të vënies në lëvizje të çështjeve.

Për shkak të rritjes së punës të Njërive të Përbashkëta Hetimore dhe specifikës së çështjeve të hetuara prej tyre, cmojmë se do të ishte në shërbim të mirëfunksionimit të sistemit të drejtësisë organizimi i kolegjeve të specializuara për të gjykuar çështjet e trajtuara nga strukturat tona. Në vazhdim të kësaj ideje do të ishte shumë i vlefshëm dhe trajnimi i përbashkët i gjyqtarëve të këtyre kolegjeve me prokurorët e Njërive të Përbashkëta Hetimore për këtë kategori veprash penale. Mungesa e këtij organizimi dhe trajnimeve, në gjykimin tonë ka ndikuar në mosvlerësimin dhe mosgjykimin e drejtë të akuzave të ngritura nga prokurorët e Njërive të Përbashkëta hetimore për veprat penale të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës dhe pastrimit të parave. Kjo pasqyrohet në vlerësimin e ndryshëm të gjykatës për personat që kanë kryer këto vepra penale, si për masat e sigurimit, ashtu dhe për deklarimin e fajësisë dhe për caktimin e llojeve e masave të dënimit ndaj autorëve të tyre.

Gjithashtu, problem shqetësues për Prokurorinë, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë negativisht në përpjekjet për rritjen e integritetit profesional dhe moral të prokurorëve, është bërë rikthimi në punë, me vendime gjyqësore të disa prokurorëve të shkarkuar nga detyra, me

Dekret të Presidentit të Republikës, apo edhe shfuqizimi nga gjykata, i masave të tjera disiplinore, të dhënë nga Prokurori i Përgjithshëm, bazuar në nenin 33 të Ligjit Nr.8737, datë 12.02.2001 për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

Gjatë dy viteve të fundit, janë shfuqizuar të gjithë Dekretet e Presidentit të Republikës për shkarkimin e prokurorëve nga detyra, si dhe masat disiplinore të dhëna nga Prokurori i Përgjithshëm, të cilat janë ankimuar në Gjykatat Shqiptare. Janë marrë vendim për rikthim në detyrë të 5 prokurorëve të shkarkuar për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë kryerjes së detyrës, si dhe janë shfuqizuar 2 masa disiplinore të dhëna për dy prokurorë nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm për rikthimin në detyrë.

- Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive janë ndërtuar bazuar në ligj dhe në memorandumet e bashkëpunimit me secilin prej tyre. Ne i kemi konsideruar dhe i konsiderojmë këto institucione si burim i rëndësishëm dhe i vlefshëm për referimin e grup veprave penale që lidhen me korrupsionin, krimin në detyrë dhe krimin financiar. Në vitin 2011 nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë paraqitur 6 kallëzime penale të cilat kanë qenë për nëpunës të nivelit të ulët për veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

Nga ILDKP janë paraqitur 16 kallëzime penale, nga të cilat kanë qenë 11 raste për refuzim deklarimi dhe 5 raste për deklarim të rremë. Subjektet e kallëzuara kanë qenë kryesisht funksionarë të pushtetit lokal dhe punonjës të tatimeve dhe doganave. Nga këto janë regjistruar 16 procedime penale, janë përfunduar 12 dhe 4 procedime janë në fazën e hetimeve. Nga 12 të përfunduarat, 9 janë dërguar për gjykim dhe 3 procedime janë pushuar. Konstatohet në mënyrë të vazhdueshme një qëndrim të konsoliduar të gjykatave në drejtim të pafajësisë në gjykimin e këtyre çështjeve mbështetur mbi analizën e anës subjektive si element i figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 257/a të Kodit Penal.

## MARRËDHËNIET ME MISIONET NDËRKOMBËTARE

Prokuroria shqiptare është asistuar edhe në vitin 2011 nga projektet e financuara nga partnerët tanë ndërkombëtarë, kryesisht nga Komisioni Evropian dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

- Prokuroria e Përgjithshme ka filluar të zbatojë nga muaji mars 2011, një projekt binjakëzimi të financuar nga Komisioni i Bashkimit Evropian me objekt mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimit financiar në Shqipëri, i cili sipas kontratës AL-2009-IB-JH-03, do të zhvillohet në periudhën 28 shkurt 2011 deri më 27 shkurt 2013. Ky projekt, sipas kontratës, po implementohet nga Instituti Spanjoll i Studimeve Fiskale. Buxheti i këtij projekti i investuar tërësisht nga Bashkimi Evropian është 1.5 milion euro.

Institucionet përfituese nga ky projekt janë Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Patrimin të Parave dhe Agjensia për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Objektivat e këtij projekti janë:

1. Përmirësimi i koordinimit mes institucioneve përfituese, veçanërisht mes Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit;
2. Forcimi i veprimit të Ligjit Antimafia përsa i përket parandalimit dhe konfiskimit të aseteve;
3. Përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe veprimeve procedurale që kryejnë entet përfituese në identifikimin, gjetjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të paligjshme;
4. Adoptimi i masave me qëllim uljen e përdorimit të parasë cash në treg;
5. Përmirësimi i koordinimit ndërkombëtar në identifikimin, gjetjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të paligjshme;
6. Përmirësimi i koordinimit mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive të shkallës së parë, veçanërisht Njësive të Përbashkëta Hetimore

Në kuadër të projektit janë zhvilluar për vitin 2011 rreth 40 aktivitete të natyrave të ndryshme si seminare trajnuese, tavolina të rrumbullakëta, ëorkshop-e, vizita studimore.

Janë trajnuar rreth 100 prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave, në identifikimin, gjetjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të paligjshme, teknikat më të mira bashkëkohore evropiane në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, krimin e jakave të bardha dhe krimin e organizuar.

Në këto aktivitete është këmbëngulur veçanërisht në kuptimin dhe interpretimin e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal oPastrimi i produkteve të veprës penaleo në përputhje me Konventën e Varshavës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë.

Nga ana e ekspertëve të këtij projekti në bashkëpunim me projektin PAMECA, po punohet në mënyrë intensive për hartimin e një manuali në lidhje me hetimet për veprën penale të pastrimit të parave, i cili do të jetë në dispozicion të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve.

Mungesa e një aplikacioni të centralizuar për Prokurorinë Shqiptare që të administrojë të gjithë informacionin e të gjitha Prokurorive të Rretheve Gjyqësore dhe të Apeleve si dhe mungesa e një lidhjeje fizike ndërmjet të gjitha Prokurorive me Prokurorinë e Përgjithshme e bën shumë të vështirë shkëmbimin e informacionit në kohë reale, eficiente dhe të koordinuar për të rritur kështu aktivitetin efektiv të Prokurorisë.

- Për të përmbushur këtë mungesë, Prokuroria shqiptare është angazhuar në plotësimin e detyrave të saj për të bërë të mundur përfitimin e projektit të Menaxhimit të rasteve për Prokurorinë Shqiptare. Ky projekt, në vlerë 3.5 milion Euro financohet nga Komisioni Evropian në kuadër të IPA 2009.

Projekti Menaxhimi i Rasteve parashikon edhe lidhjen fizike të Prokurorëve të rretheve gjyqësore me Prokurorinë e Përgjithshme, duke krijuar kështu një rrjet fizik mbi të cilin do të funksionojë Programi Menaxhimi i Rasteve.

Aktualisht jemi në fazën e fundit të këtij projekti i cili është hartimi i specifikimeve të pajisjeve hardëarike si dhe të dezijimit elektronik të softëare.

- Instalimi dhe konfigurimi i TIMS (Total Information Management System) financiar nga OPDAT

Një projekt tjetër i rëndësishëm për Prokurorinë Shqiptare është edhe implementimi i TIMS (Total Management Information System) i financiar nga OPDAT.

Gjatë vitit 2011 është bërë e mundur ndërtimi i rrjeteve informatike lokale për 10 prokurori të rretheve gjyqësore si dhe kabllimi optic i 20 prokurorive të rretheve gjyqësore me Drejtoritë e Policisë në rrethet përkatëse. Kjo lidhje ka bërë të mundur aksesimin e databases së TIMS për prokurororët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore të këtyre prokurorive ku është bërë e mundur lidhja fizike. Ky system do të shërbejë për marrjen e të dhënave në lidhje me shtetasit shqiptarë dhe automjetet që lëvizin brenda dhe jashtë vendit.

Përveç projekteve të përmendura më lartë, Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit të kaluar ka qënë e përfshirë dhe ka përfituar nga asistenca në disa projekte të financuara nga strukturat e Bashkimit Evropian (nëpërmjet misionit EURALIUS), Këshillit të Evropës (nëpërmjet projektit PACA), Qeverisë së SHBA (nëpërmjet OPDAT dhe MCC) e donatorëve të tjerë. Ajo që duhet thënë është se kjo asistencë kanë patur një impakt shumë pozitiv në punën e prokurorisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale.

## V. PRIORITETET E PROKURORISË PËR VITIN 2012

Duke konsideruar prioritetet e shpallura nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, në strategjitë kombëtare të miratuara, në progres raportin dhe në rekomandimet që vijnë nga partnerët e huaj për shkak të angazhimeve të shtetit shqiptar në organizmat ndërkombtare, si dhe në problematikat e punës së organit të prokurorisë dhe tendencat e kriminalitetit të evidentuara gjatë vitit 2011, prokuroria shqiptare ka përcaktuar prioritetet për vitin 2012 si më poshtë:

- ✚ Përmirësimi dhe rritja e vazhdueshme e bashkëpunimit me Policinë Gjyqësore me synim përmirësimin e funksionimit të shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe me policitë gjyqësore të institucioneve të tjera.
- ✚ Bashkëpunimi ndër-institucional me Ministrinë e Drejtësisë vlerësohet, gjithashtu, aspekt i rëndësishëm që ndikon në rritjen e efektivitetit të punës së organit të prokurorisë. Bazuar në ligjin për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja, do të synojmë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përkatëse në dy institucionet. Përmirësimin e marrëdhënieve përsa i përket kontrolleve dhe inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë në sistemin e prokurorisë në funksion të transparencës dhe të pavarësisë. Rritjen e bashkëpunimit në grupet e përbashkëta të punës në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë penale.
- ✚ Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomiko- financiar dhe krimit kompjuterik ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet e punës së prokurorisë. Në funksion të këtij prioriteti, me synim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, si dhe për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin në hetimin dhe ndjekjen penale kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, do të vazhdojë të mbështetet në të gjitha drejtimet puna e 7-të njësisë të përbashkëta të ngritura për këtë qëllim, duke orientuar rritjen e numrit të hetimeve proaktive.
- ✚ Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafiqeve të paligjshme dhe pastrimit të parave do të vazhdojë të jetë prioriteti i punës sonë. Për realizimin e këtij prioriteti do të fokusohemi kryesisht:
  - ❖ Në forcimin e bashkëpunimit me agjensitë e zbatimit të ligjit brenda vendit, duke i dhënë rrugë kryesisht hetimeve proaktive për goditjen e këtij lloj kriminaliteti.
  - ❖ Zbatimin me efikasitetin e duhur të ligjit òPër parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.
  - ❖ Zbatimin me efikasitet të ligjit òPër mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.
  - ❖ Shfrytëzimin në maksimum të gjithë materialit informativ që vjen nga agjensitë e ndryshme të shërbimeve inteligjente.

- ❖ Në forcimin e bashkëpunimit me agjensitë e huaja të zbatimit të ligjit, duke tentuar të përdorim sa më shumë hetime paralele dhe të rrisim fleksibilitetin në shkëmbimin e informacionit.
  - ❖ Në vazhdimin e trajnimeve për të qartësuar kuptimin dhe zbatimin e ndryshime të reja ligjore dhe për përmirësimin e përdorimit më me efektivitet të metodave të posaçme të hetimit.
- ✚ Rritja e efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale të vjedhjes së pasurisë me tendencë në rritje në vitin e kaluar do të jetë prioritet i prokurorisë për sa kohë ajo konsiderohet e lidhur ngushtë me sigurinë publike, duke
- ❖ Forcuar bashkëpunimin me strukturat e policisë së shtetit;
  - ❖ Forcuar kontrollin periodik të procedimeve penale në ndjekje dhe atyre të pezulluara për këto vepra penale.
  - ❖ Ashpërsimin e politikës penale në drejtim të autorëve të këtyre veprave penale.
- ✚ Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore mbetet prioritet edhe për vitin në vazhdim. Në këtë kuadër vëmendje do të kushtohet:
- ❖ Rritjes së transparencës në emërimin dhe promovimin e prokurorëve.
  - ❖ Rritjes së transparencës në procesin e inspektimit dhe procedimit disiplinor të prokurorëve.
  - ❖ Rritjen e nivelit profesional nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe të specializuara të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.
  - ❖ Vënies në efikasitet të sistemit të vlerësimit të prokurorëve.
  - ❖ Vënien në efikasitet të sistemit të vlerësimit të oficerëve të policisë gjyqësore në zbatim të ligjit për policinë gjyqësore.
  - ❖ Rritjes së integritetit të prokurorit dhe oficerëve të policisë gjyqësore duke synuar përmirësimin e motivimit nëpërmjet shpërblimeve financiare.
  - ❖ Shfrytëzimit maksimal të gjithë produktit të përfituar nga projektet e huaja në mbështetje të Prokurorisë së Përgjithshme.
  - ❖ Përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore për përmirësimin e kushteve dhe ambjenteve të punës për prokurorët.

Në vlerësim të treguesve të punës së prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë në emër të shtetit dhe në vënien në ekzekutim të vendimeve

gjyqësore të formës së prerë, theksojmë se Prokuroria Shqiptare ka realizuar me sukses angazhimet, rekomandimet dhe detyrat kushtetuese e ligjore në rritjen e efektivitetit dhe të ligjshmërisë në ushtrimin e funksioneve të saj.

Megjithë arritjet në vitin 2011, sfida dhe probleme të mëdha kemi përpara. Tendencat në rritje të kriminalitetit të paraqitura në këtë raport do të jenë në fokusin e punës tonë për vitin 2012.

Ju siguroj se Prokuroria në të gjitha hallkat e saj do të realizojë prioritetet në luftë kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe krimit të organizuar, korrupsionit në veçanti duke rritur efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit si dhe duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Kemi synuar dhe do të synojmë ta ngrejmë drejtësinë shqiptare drejt standarteve që i kemi aspiruar prej kohësh duke u përpjekur për të bërë më të mirën për të rritur më tej vlerat e kësaj hallke të sistemit kaq të rëndësishëm të drejtësisë penale në Shqipëri.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**INA RAMA**